



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 33

Tiranë – E martë, 1 mars 2022

PËRMBAJTJA

	Faqe	
Ligj nr. 12/2022, datë 3.2.2022	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Greqisë, për ngritjen dhe funksionimin e një qendre të përbashkët policore dhe doganore.....	3665
Dekret i Presidentit nr. 13491, datë 25.2.2022	Për shpallje ligji.....	3671
Ligj nr. 14/2022, datë 3.2.2022	Për një ndryshim në ligjin nr. 7918, datë 13.4.1995, “Për miratimin me ndryshime të dekretit nr. 1030, datë 23.2.1995, ‘Për emetimin dhe shpërndarjen e bonove të privatizimit (lekëve të privatizimit)’, dhe dekretit nr. 1049, datë 27.3.1995, ‘Për disa plotësime në dekretin nr. 1030, datë 23.2.1995’”, të ndryshuar.....	3672
Dekret i Presidentit nr. 13492, datë 25.2.2022	Për shpallje ligji.....	3672
Ligj nr. 15/2022, datë 3.2.2022	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve”.....	3672
Dekret i Presidentit nr. 13493, datë 25.2.2022	Për shpallje ligji.....	3677
Ligj nr. 17/2022, datë 17.2.2022	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Spanjës, si shtesë e Konventës Evropiane për Ekstradimin, të vitit 1957.....	3677
Dekret i Presidentit nr. 13494, datë 25.2.2022	Për shpallje ligji.....	3678
Ligj nr. 18/2022, datë 17.2.2022	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Kuadër për Etikën në Turizëm dhe protokollin opsional të saj.....	3679

Dekret i Presidentit nr. 13495, datë 25.2.2022	Për shpallje ligji.....	3689
Vendim i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 2, datë 23.2.2022	Për disa shtesa e ndryshime në vendimin nr. 4, datë 11.3.2019, të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve, për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, të ndryshuar.....	3690
Vendim i Këshillit të Lartë të Prokurorisë nr. 32, datë 24.2.2022	Për miratimin e “Standardeve të etikës dhe rregullave të sjelljes së prokurorit”	3692



LIGJ
Nr. 12/2022

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
NDËRMJET KËSHILLIT
TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE QEVERISË
SË REPUBLIKËS SË GREQISË, PËR
NGRITJEN DHE FUNKSIONIMIN
E NJË QENDRE TË PËRBASHKËT
POLICORE DHE DOGANORE

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Greqisë, për ngritjen dhe funksionimin e një qendre të përbashkët policore dhe doganore, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 3.2.2022.

Shpallur me dekretin nr. 13491, datë 25.2.2022, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË GREQISË,
MBI NGRITJEN DHE FUNKSIONIMIN E
NJË QENDRE TË PËRBASHKËT POLICORE
DHE DOGANORE

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Greqisë (në vijim të referuara si “Palët”);

me qëllim forcimin e bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve të tyre kompetente;

me synim rritjen e efikasitetit në luftën kundër krimit të organizuar dhe rrjeteve të tij, migracionin e paligjshëm, trafikimin e lëndëve narkotike, ekstremizmin e dhunshëm, radikalizmin, si dhe krime të tjera të rënda;

duke qenë të ndërgjegjshëm për shkallën e krimit ndërkufitar, si edhe nevojën për të marrë masa të përbashkëta kundër kërcënimeve ndërkufitare, si dhe të vendosur për të luftuar bashkërisht me efikasitet krimin ndërkufitar;

me dëshirën për të përmirësuar shkëmbimin e informacionit ndërmjet autoriteteve të tyre kompetente;

me dëshirën për të vendosur një kuadër dhe standarde të përbashkëta mbi çështjet e lartpërmendura, të krijuara në përputhje me kërkesat dhe normat e Bashkimit Evropian;

duke respektuar marrëveshjet ndërkombëtare dhe legjislacionin kombëtar të të dy shteteve, si dhe pa cenuar angazhimet e tyre të mëparshme, bazuar në marrëveshje dypalëshe dhe shumëpalëshe me vende të treta,

kanë rënë dakord si më poshtë:

KAPITULLI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Përkufizimet

Me qëllim zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, termat më poshtë kanë kuptimin si vijon:

1. Qendër e Bashkëpunimit (e quajtur më pas si “Qendra”) – një qendër që kryen shkëmbimin e informacionit dhe asiston veprimtaritë e autoriteteve të policisë dhe autoritetet doganore të Palëve.



2. Zyrtarë – përfaqësues të Autoriteteve Kompetente, të përmendur në nenin 3 të kësaj Marrëveshjeje, të cilët kryejnë detyrat në Qendër, në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar dhe dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

3. Koordinator – përfaqësues i caktuar nga Autoritetet Kompetente të Palëve, i cili organizon dhe kontrollon veprimtaritë e përfaqësuesve të vendit të tij apo të saj në Qendër.

4. Komisioni i përbashkët – përfaqësues nga secila palë, i referuar në nenin 9 të kësaj Marrëveshjeje, i cili miraton dhe aprovon “Rregulloren e procedurës për organizimin dhe funksionimin e Qendrës” (në vijim referuar si “Rregullorja”) dhe monitoron zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

5. Krim ndërkuftar – një krim përkufizohet me natyrë ndërkuftare, nëse:

a) kryhet në më shumë se një shtet;

b) kryhet në një shtet por një pjesë kryesore e përgatitjes, planifikimit, drejtimit dhe kontrollit të tij ndodh në një shtet tjetër;

c) kryhet në një shtet por përfshin një grup kriminal të organizuar, i cili përfshihet në veprimtari kriminale në më shumë se një shtet; ose

d) kryhet në një shtet por ka ndikime thelbësore në një shtet tjetër.

Neni 2

Krijimi

1. Palët bien dakord të krijojnë një Qendër për shkëmbimin e informacionit dhe koordinimin e bashkëpunimit nëpërmjet Qendrës ndërmjet Autoriteteve, referuar në nenin 3 të kësaj Marrëveshjeje.

2. Qendra do të pozicionohet në territorin e Republikës së Greqisë, në pikën e kalimit kuftar të Kakavijës.

3. Autoritetet Kompetente të Palëve nuk mund të përdorin Qendrën për shkëmbim të informacionit, bashkëpunim dhe koordinim, në lidhje me çështjet në fushën e marrëdhënieve detare ndërmjet Palëve.

4. Emri i Qendrës do të jetë në formë të shkruar me një mbishkrim në gjuhët greke, shqipe dhe angleze, sipas Rregullores së procedurës.

Neni 3

Autoritetet Kompetente

Autoritetet Kompetente të Palëve, për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, janë si më poshtë:

Për Republikën e Shqipërisë:

- Ministria e Brendshme – Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit/Departamenti për Kufirin dhe Migracionin;

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë – Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Për Republikën e Greqisë:

- Ministria e Mbrojtjes së Qytetarëve – Policia Greke;

- Autoriteti i Pavarur i të Ardhurave Publike – Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Akcizës.

Neni 4

Rregulla të përbashkëta në funksionimin e Qendrës

1. Qendra nuk do të ketë personalitet juridik.

2. Orët e punës së Qendrës do të përcaktohen në Rregullore.

3. Qendra do të punësojë përfaqësues të Autoriteteve Kompetente të Palëve, të cilët kryejnë analizën dhe shkëmbimin e informacionit, si edhe mbështesin ekzekutimin e veprimtarive të Autoriteteve Kombëtare Kompetente, siç referohet në nenin 3 të kësaj Marrëveshjeje.

4. Qendra do të administrohet nga koordinatorët e secilës palë. Funksionet dhe detyrat e koordinatorëve, ashtu si edhe sqarimet e mëtejshme, në lidhje me menaxhimin administrativ, do të rregullohen nga “Rregullorja”, të cilat do të firmosen nga Komiteti i Përbashkët. Organizimi i veprimtarive dhe ndërveprimi ndërmjet zyrtarëve të Autoriteteve Kompetente të Palëve do të jetë i shkruar në Rregullore.

5. Shkëmbimi i informacionit ndërmjet palëve kërkuese dhe të kërkua do të bëhet mbi bazën e interesave të përbashkëta dhe parimit të barazisë, dhe gjithashtu duke marrë në konsideratë parimin e reciprocitetit.



KAPITULLI II FUSHAT DHE METODAT E BASHKËPUNIMIT

Neni 5 Detyrat e Qendrës

Në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar dhe me përjashtim të bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar, Autoritetet Kompetente të Palëve do të bashkëpunojnë nëpërmjet Qendrës, në fushat e mëposhtme:

a) shkëmbimi i të dhënave dhe informacionit me kërkesë, sipas procedurave të cilat do të vendosen me rregullore;

b) vlerësim dhe analizë e përbashkët, bazuar në të dhënat dhe informacionin në dispozicion, me qëllim kryerjen e analizës së riskut;

c) asistencë dhe koordinim i veprimtarive të strukturave të tjera të Autoriteteve Kompetente, siç referohet në nenin 3 të kësaj Marrëveshjeje;

d) shkëmbimi i informacionit në formë të shkruar, në formate specifike, me iniciativë të njëjës prej tyre, pa kërkesë, për t'i mundësuar palës tjetër asistencë në parandalimin dhe luftën kundër krimeve, ose në rast kërcënimesh ndaj rendit publik dhe sigurisë;

e) bashkëpunimi me qendrat e tjera për bashkëpunim policor dhe doganor, subjekt i miratimit të përbashkët të koordinatorëve të përfshirë dhe në përputhje me legjislacionin kombëtar.

Neni 6 Shkëmbimi i informacionit

1. Shkëmbimi i informacionit të përshkruar në nenin 4, në veçanti, do t'i referohet çështjeve të mëposhtme:

a) legjislacionit përkatës kombëtar të palëve;

b) migracionit të paligjshëm, kontrabandimit të emigrantëve dhe refugjatëve/trafikimi i qenieve njerëzore dhe veprimtaritë e paligjshme që lidhen me to;

c) ekstremizmit të dhunshëm dhe rekrutimit të luftëtarëve të huaj;

d) krimeve dhe shkeljeve që lidhen me falsifikimin e dokumenteve të udhëtimit, kartave të identitetit, vizave dhe lejeve të qëndrimit, duke

përfshirë modelet e dokumenteve të përdorura për kryerjen e veprimtarive ilegale;

e) krimeve dhe shkeljeve që lidhen me kultivimin e paligjshëm, prodhimin, eksportin, transportin dhe trafikimin e lëndëve narkotike dhe substancave psikotrope, prekursorëve, si dhe trafikimin e armëve, municioneve, lëndëve plasëse, mallrave me përdorim të dyfishtë, armëve biologjike dhe kimike, materialeve toksike, bërthamore dhe radioaktive;

f) krimeve dhe shkeljeve që kanë, në lidhje me mjetet motorike;

g) situatave të emergjencës ose shfaqjes së situatave që mund të ndikojnë në kryerjen me sukses të kontroleve kufitare në kufijtë e përbashkët të shteteve të palëve;

h) personave të cilëve iu është refuzuar hyrja në territoret e shteteve të palëve;

i) shkeljeve ose përpjekjeve për të shkelur legjislacionin kombëtar të njëjës prej palëve në kalimin e kufirit të shtetit të tij;

j) trafikimit të paligjshëm të pasurisë kulturore;

k) personave të humbur;

l) krimin të organizuar që lidhet me pronën, vjedhjes së metaleve, si edhe kontrabandimit dhe transportit të të ardhurave që rrjedhin nga veprimtaria kriminale;

m) informacionit mbi lejet e drejtimit dhe dokumentet e automjeteve;

n) vendbanimi, vendqëndrimi dhe lejet e qëndrimit;

o) krimeve dhe shkeljeve, në lidhje me kontrabandimin e parave të falsifikuara, karburanteve, cigareve, piraterisë dhe produkteve të falsifikuara, specieve të listuar nga CITES, konkretisht “Konventën mbi tregtinë ndërkombëtare të specieve të rrezikuara të faunës dhe florës së egër”, nënshkruar në Uashington DC, më 3 mars 1973, përmirësuar në Bon, më 22 qershor 1979, dhe çdo vepër tjetër penale dhe shkelje kundër rregullave të doganave dhe akcizave;

p) shkeljeve gjatë transportit të mallrave, të cilat i nënshtrohen procedurës së përbashkët të tranzitit.

Neni 7 Mënyra e komunikimit

1. Shkëmbimi i informacionit ndërmjet Autoriteteve Kompetente të Palëve do të kryhet



nëpërmjet Qendrës në përputhje me rregullat e shkruara në Rregullat.

2. Kërkesat dhe përgjigjet duhet të bëhen në formë të shkruar, në një formë standarde të përcaktuar në Rregullore.

3. Në raste emergjence do të pranohet një kërkesë verbale, duke siguruar se kërkesa dhe përgjigja përkatëse janë regjistruar shkurtimisht në një ditë të veçantë, dhe konfirmuar me shkrim të paktën 24 orë pas marrjes së tyre.

4. Pala kërkuese duhet të shprehë qëllimet përse do të përdoret informacioni dhe nëse ato do të përdoren nga autoritetet e tjera kompetente.

5. Zyrtarët e Qendrës do të jenë të detyruar të regjistrojnë dhe të arkivojnë të gjitha kërkesat dhe përgjigjet. Përdorimi dhe ruajtja e dokumenteve në Qendër do të kryhet në përputhje me dispozitat e legjislacionit kombëtar në fuqi, që kanë të bëjnë me autoritetet përkatëse.

6. Komunikimi nëpërmjet Qendrës do të kryhet në gjuhët shqipe, greke dhe angleze.

KAPITULLI III STRUKTURA DHE ORGANIZIMI I QENDRËS

Neni 8 Statusi i zyrtarëve

1. Zyrtarët e caktuar në Qendër do të kryejnë detyrat e tyre në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar të palës që përfaqësojnë, duke respektuar legjislacionin e palës në territorin e së cilës krijohet Qendra.

2. Secila palë do të caktojë një numër të barabartë personeli nga ana e Autoriteteve të tyre Kompetente për të punuar në Qendër.

3. Zyrtarët e caktuar në Qendër nuk do të marrin pjesë drejtpërdrejtë në ekzekutimin e veprimtarive operacionale dhe në kryerjen e kontrolleve kufitare në shtetin e palës tjetër.

4. Zyrtarët e caktuar në Qendër do të veshin uniforma me emblemën e njësisë përkatëse të shërbimit.

5. Përgjegjësia për çdo dëm të shkaktuar nga zyrtarët e caktuar në Qendër do të jetë në përputhje me legjislacionin kombëtar përkatës të këtyre zyrtarëve.

6. Dispozitat e ligjeve penale të palës greke mbi mbrojtjen e punonjësve civilë dhe veprimtarinë e

tyre do të zbatohen për shkeljet e kryera kundër zyrtarëve të palës tjetër të caktuar në Qendër, kur janë në punë ose në lidhje me punën e tyre.

7. Secila palë do të ushtrojë kompetenca administrative e disiplinore ekskluzivisht mbi zyrtarët e saj të caktuar në Qendër. Zyrtarët e caktuar në Qendër janë objekt i detyrimeve administrative dhe disiplinore sipas legjislacionit të tyre përkatës kombëtar.

8. Koordinatorët do t'i mundësojnë njeri-tjetrit një listë me emrat e zyrtarëve të caktuar në Qendër. Çdo ndryshim në këtë listë do të raportohet me shkrim, në kohën e duhur, te koordinatori i palës tjetër.

9. Zyrtarët e caktuar në Qendër do të hyjnë dhe dalin nga Qendra me karta shërbimi të lëshuara nga pala greke. Kartat e shërbimit mund të përdoren gjithashtu nga zyrtarët për hyrje dhe dalje nga territori i Republikës Greke, në lidhje me kryerjen e detyrave të tyre.

Neni 9

Statusi i komisionit të përbashkët

1. Me anë të kësaj Marrëveshjeje, Palët krijojnë një komision të përbashkët, i cili do të përbëhet prej katër përfaqësuesish të secilës palë (dy nga secili Autoritet Kompetent i secilës palë), dhe do të mbledhet dy herë në vit në Qendër. Palët do të njoftojnë njëra-tjetrën, nëpërmjet kanaleve diplomatike, mbi anëtarët e tyre përkatës të komisionit të përbashkët.

2. Komisioni do të përgatisë dhe miratojë unanimisht Rregullat e tij të Procedurës.

3. Komisioni do të përgatisë dhe miratojë unanimisht Rregullat e Procedurës mbi Organizimin dhe Funkcionimin e Qendrës.

4. Rregullat e Procedurës së Komitetit të Përbashkët dhe Rregullat e Procedurës mbi Organizimin dhe Funkcionimin e Qendrës do të nënshkruhen nga pala greke nga drejtori i Divizionit të Bashkëpunimit Policor Ndërkombëtar të Policisë Greke dhe për palën shqiptare nga drejtori i Departamentit për Kufirin dhe Migracionin. Personat e lartpërmendur do të jenë kryetarë të komisionit të përbashkët.

5. Komisioni do të monitorojë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, do të identifikojë masat e nevojshme për zbatim dhe do të propozojë protokolle zbatuese, me qëllim adresimin e masave



specifike lidhur me aplikimin dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Këto protokolle zbatuese do të miratohen nga Autoritetet Kompetente, sipas legjislacionit të tyre kombëtar.

6. Komisioni do të përgatisë një raport, në lidhje me funksionimin dhe veprimtaritë e Qendrës, duke vlerësuar veprimtaritë e Qendrës mbi bazë vjetore.

Neni 10

Pajisjet dhe kostot

1. Secila palë do të mundësojë pajisjet e nevojshme të komunikimit dhe ato teknike (telefon, faks, kompjuter, etj.) për nevoja të zyrtarëve të saj.

2. Pala greke do të mundësojë pajisjet e zyrës (tavolina, karrige, raftë etj.) për nevojat e zyrtarëve të Qendrës.

3. Shpenzimet që do të lindin nga veprimtaria e Qendrës (mirëmbajtja, energjia elektrike, furnizimi me ujë dhe ngrohja) do të sigurohen nga pala pritëse. Secila palë do të mbulojë shpenzimet për personelin e saj dhe materialet (si telefonat dhe shpenzimet për internetin).

4. Palët do të mundësojnë ngritjen e rrjeteve të telekomunikacionit, aksesin në bazën kombëtare të të dhënave, sistemet e përpunimit të të dhënave dhe internetin, të cilat janë të nevojshme për veprimtaritë e zyrtarëve në Qendër. Secila palë do të marrë masat lidhur me mbrojtjen e privatësisë së komunikimit.

5. Pala greke do të jetë përgjegjëse për marrjen e masave të nevojshme organizative për sigurinë e Qendrës.

6. Nëse është e nevojshme, secila palë do të vendosë personel për mirëmbajtjen dhe riparimin e pajisjeve të përdorura në Qendër nga vetë zyrtarët.

Neni 11

Trajnimi

1. Brenda kuadrit të kësaj Marrëveshjeje, Palët mund të shkëmbejnë ekspertë, me qëllim trajnimin dhe përfitimimin nga ekspertiza e tyre dhe mund të organizojnë trajnime të përbashkëta, nëse është e nevojshme.

2. Në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar, Autoritetet Kompetente të palëve mund të shkëmbejnë ekspertizë nëpërmjet Qendrës, në

lidhje me çështjet e parashtruara në këtë Marrëveshje, me qëllim thjeshtësimin dhe harmonizimin e procedurave dhe praktikave.

KAPITULLI IV

MBROJTJA E TË DHËNAVE DHE TË INFORMACIONIT

Neni 12

Mbrojtja e të dhënave personale

Shkëmbimi i ndërsjellë i të dhënave personale ndërmjet Autoriteteve Kompetente të Palëve do të kryhet në përputhje me legjislacionin përkatës kombëtar, duke pasur parasysh kushtet e përcaktuara nga Autoriteti Kompetent ofrues dhe parimet vijuese, të cilat zbatohen si për përpunimin e të dhënave automatike dhe joautomatike.

1. Të dhënat e siguruar nuk do të përdoren për qëllime të ndryshme nga ato për të cilat janë siguruar fillimisht, pa pëlqimin e Autoritetit ofrues.

2. Të dhënat e siguruar do të shkatërrohen/përditësohen nëse:

a) e dhëna tregon që është e pasaktë; ose

b) Autoriteti Kompetent ofrues ka informuar se të dhënat janë mbledhur ose siguruar në kundërshtim me ligjin; ose

c) të dhënat nuk janë më të nevojshme për qëllimin për të cilin janë siguruar, me përjashtim kur ka një autorizim të qartë nga Autoriteti ofrues për përdorim të të dhënave të ofruara edhe për qëllime të tjera.

3. Me kërkesë të Autoritetit Kompetent ofrues, Autoriteti Kompetent marrës do të sigurojë informacion mbi përdorimin e të dhënave.

4. Autoriteti kompetent ofrues do të garantojë saktësinë dhe eficiencën, dhe kushteve moderne të të dhënave të mundësuar. Në rast se verifikohet se të dhënat e mundësuar janë të pasakta ose nuk duhej të ishin mundësuar, ose në rast se ka një kërkesë me asgjësimin e të dhënave të marra në një fazë të mëvonshme në legjislacionin kombëtar përkatës të Autoritetit ofrues ose marrës, Autoritetit Kompetent ofrues ose marrës do të njoftohet menjëherë në mënyrë që të bëjë asgjësimin e tyre ose që të bëjë korrigjimet përkatëse sipas paragrafit 2 të këtij neni.

5. Autoriteti Kompetent ofrues do të jetë i detyruar që të mbrojë në mënyrë efikase të dhënat e siguruar kundrejt aksesit të paautorizuar,



modifikimeve ose shpërndarjes. Palët do të sigurojnë masat e nevojshme organizative dhe teknike për të mbrojtur të gjitha të dhënat e shkëmbyera nga humbja aksidentale, asgjësimi aksidental ose i paligjshëm, aksesit i paautorizuar, modifikimi, shpërndarja, asgjësimi ose fshirja.

6. Në rast të aksesit të paautorizuar ose shpërndarjes së të dhënave të siguruara, Autoriteti Kompetent marrës do të informojë në mënyrë të menjëhershme Autoritetin Kompetent ofrues në lidhje me rrethanat që kanë të bëjnë me aksesin ose shpërndarjen e paautorizuar, si dhe në lidhje me masat e marra për shmangien e incidenteve të tilla në të ardhmen.

7. Të dy Autoritetet, ofrues dhe marrës, do të jenë të detyruar të mbajnë një regjistër për sigurimin, marrjen, ndryshimin ose asgjësimin e të dhënave.

8. Pas mundësimit të të dhënave, Autoriteti Kompetent Ofrues do të informojë Autoritetin Kompetent Marrës, në përputhje me legjislacionin e tij kombëtar, për periudhën brenda të cilës të dhënat duhen asgjësuar, si edhe për çdo kufizim në lidhje me përdorimin e tyre, fshirjen ose asgjësimin, duke përfshirë kufizime të mundshme lidhur me aksesin. Kur nevoja e kufizimeve të tilla është përcaktuar pas transferimit të të dhënave, Palët informojnë më tej njëra-tjetrën në një fazë të mëvonshme.

9. Me anë të një kërkesë me shkrim, personi, të dhënat e të cilit sigurohen ose janë siguruar do të marrë informacion mbi të dhënat e siguruar dhe qëllimin për të cilin ato do të përdoren, në përputhje me legjislacionin kombëtar të palëve. Nëse personi dorëzon një kërkesë për aksesim, modifikim ose asgjësim të këtyre të dhënave, Autoriteti Kompetent Marrës do të ndërmarrë një vendim në përputhje me deklaratën e Autoritetit Kompetent Ofrues, në secilin rast kjo deklaratë do të bëhet në zbatim të legjislacionit kombëtar të zbatueshëm.

10. Kur Autoriteti Kompetent merr një kërkesë për informim nga një shtetas i palës duhet të informojë menjëherë Autoritetet Kompetente të palës tjetër përpara ofrimit të një informacioni të tillë.

11. Të dhënat nuk mund t'i sigurohen një palë të tretë, përfshirë qendra të tjera për bashkëpunim policor dhe doganor, me përjashtim të miratimit me shkrim paraprak të palës ofruese.

12. Secila palë do të ketë të drejtën të refuzojë mundësimin e të dhënave në rast se mundësimi i tyre mund të kërcënojë sigurinë kombëtare ose rendin publik, ose është në kundërshtim me legjislacionin kombëtar dhe me *acquis-communautaire* të Republikës së Greqisë.

13. Palët do të ndërmarrin të gjithë masat e nevojshme, në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar, me qëllim të shmangin çdo dëm kundrejt palës së tretë, që rezulton nga sigurimi, marrja ose përdorimi i të dhënave, si edhe për të eliminuar parakushtet që çojnë në pasoja të mundshme të pafavorshme.

14. Në rast mosrespektimi të dispozitave të këtij neni nga pala marrëse, pala ofruese mund të kërkojë fshirjen ose asgjësimin e të dhënave të ofruara.

Neni 13

Shkëmbimi dhe mbrojtja e informacionit të klasifikuar

Shkëmbimi dhe mbrojtja e informacionit të klasifikuar do të kryhet në përputhje me legjislacionin kombëtar të Palëve.

KAPITULLI V

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 14

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të rrjedhin nga interpretimi apo zbatimi i kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhen nga koordinatorët. Në rastet se nuk arrihet zgjidhja, mosmarrëveshjet do të zgjidhen nëpërmjet konsultimeve në kuadër të komisionit të përbashkët. Në rast se nuk arrihet zgjidhja e tyre nga komisioni i përbashkët, konfliktet do të zgjidhen me anë të konsultimeve ndërmjet Palëve, duke shfrytëzuar kanalet diplomatike.

Neni 15

Bashkëpunimi me organizata dhe palë të treta

Palët do të vendosin, me pëlqim të përbashkët me shkrim, për pjesëmarrjen e organizatave ose/dhe palëve të treta në Qendër. Për këtë qëllim,



do të arrihet një marrëveshje zbatimi ose do të vendosen masa rregulluese.

Neni 16
**Lidhja me marrëveshjet e tjera
ndërkombëtare**

Kjo Marrëveshje nuk do të cenojë të drejtat dhe detyrimet e Palëve që lindin nga marrëveshjet ndërkombëtare ku ato janë palë.

Neni 17
Refuzimi i bashkëpunimit

Në lidhje me sigurinë kombëtare ose interesa të tjera publike, ose në rast se nuk do të jetë në përputhje me legjislacionin kombëtar, secila palë mund të mohojë ndihmën përkohësisht, plotësisht ose pjesërisht. Pala tjetër do të informohet, menjëherë, me shkrim, në lidhje me arsyet e një refuzimi të tillë.

Neni 18
Hyrja në fuqi, ndryshimet dhe përfundimi

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi pas marrjes së njoftimit të fundit me shkrim, me anë të së cilit palët informojnë njëra-tjetrën, nëpërmjet kanaleve diplomatike, për plotësimin e procedurave të brendshme që nevojiten për hyrjen e saj në fuqi.

2. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet dhe plotësohet mbi bazë të pëlqimit të ndërsjellë me shkrim të Palëve. Ndryshimet dhe shtesat do të hyjnë në fuqi sipas procedurës së parashikuar në paragrafin 1, të këtij neni.

3. Kjo Marrëveshje do të lidhet për një periudhë prej pesë vitesh dhe do të rinovohet automatikisht për një periudhë prej pesë vitesh të njëpasnjëshme, vetëm nëse pala informon palën tjetër me shkrim për qëllimin e saj për të përfunduar këtë Marrëveshje. Në këtë rast, kjo Marrëveshje nuk do të jetë më në fuqi gjashtë muaj pas datës së marrjes së njoftimit.

4. Autoritetet doganore do të fillojnë bashkëpunimin në Qendër pasi Palët të njoftojnë njëra-tjetrën, nëpërmjet kanaleve diplomatike, mbi gatishmërinë e autoriteteve të tyre përkatëse doganore për të marrë pjesë në bashkëpunimin e Qendrës.

Nënshkruar në, më2021, në dy tekste origjinale, secila në shqip, greqisht dhe anglisht, ku të gjitha tekstet janë njëloj autentike. Në rast të ndonjë mospërputhjeje, përkthimi në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Julian Hodaj
Zëvendësministër i Brendshëm

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË
GREQISË
Eleftherios Olkonomou
Zëvendësministër i Mbrojtjes së Qytetarit

DEKRET
Nr. 13491, datë 25.2.2022

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 12/2022, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Greqisë për ngritjen dhe funksionimin e një qendre të përbashkët policore dhe doganore”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta



LIGJ
Nr. 14/2022

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 7918, DATË 13.4.1995, “PËR MIRATIMIN ME NDRYSHIME TË DEKRETIT NR. 1030, DATË 23.2.1995, ‘PËR EMETIMIN DHE SHPËRNDARJEN E BONOVE TË PRIVATIZIMIT (LEKËVE TË PRIVATIZIMIT)’, DHE DEKRETIT NR. 1049, DATË 27.3.1995, ‘PËR DISA PLOTËSIME NË DEKRETIN NR. 1030, DATË 23.2.1995’”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në fjalinë e fundit të nenit 3, të ligjit nr. 7918, datë 13.4.1995, “Për miratimin me ndryshime të dekretit nr. 1030, datë 23.2.1995, Për emetimin dhe shpërndarjen e bonove të privatizimit (lekëve të privatizimit) dhe dekretit nr. 1049, datë 27.3.1995, ‘Për disa plotësime në dekretin nr. 1030, datë 23.2.1995’”, të ndryshuar, fjalët “deri më 31.12.2021” zëvendësohen me fjalët “deri më 31.12.2023”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratur në datën 3.2.2022.

Shpallur me dekretin nr.13492, datë 25.2.2022, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

DEKRET
Nr. 13492, datë 25.2.2022

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ

Shpalljen e ligjit nr. 14/2022 “Për një ndryshim në ligjin nr. 7918, datë 13.4.1995, ‘Për miratimin me ndryshime të dekretit nr. 1030, datë 23.2.1995, ‘Për emetimin dhe shpërndarjen e bonove të privatizimit (lekëve të privatizimit)’ dhe dekretit nr. 1049, datë 27.3.1995, ‘Për disa plotësime në dekretin nr. 1030, datë 23.2.1995’, të ndryshuar”.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

LIGJ
Nr. 15/2022

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË LIGJIN NR. 105/2016,
“PËR MBROJTJEN E BIMËVE”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Kudo në ligj emërtimet: “Drejtoria Rajonale e Bujqësisë”, “Shërbimi i Mbrojtjes së Bimëve pranë DRB-së”, “Zonë e Pastër” dhe “Parazit” zëvendësohen përkatësisht me emërtimet “Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve” (AKVMB), “Autoriteti Kombëtar i



Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve”, “Zonë e Mbrojtur nga Dëmtuesit” dhe “Dëmtues”.

Neni 2

Në nenin 2 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. “Bimë” janë bimët e gjalla ose pjesët e gjalla të bimëve të mëposhtme:

- a) farat në kuptimin botanik, përveç atyre që nuk janë të destinuara për mbjellje;
- b) frutat në kuptimin botanik;
- c) perimet;
- ç) tuberët, zhardhokët, bulbet, rizomat, rrënjët, nënshartesat, stolonet;
- d) trungjet, kërcëjtë;
- dh) lulet e prera;
- e) degët me/ose pa gjethe;
- ë) pemët e prera që mbajnë gjethe;
- f) gjethet;
- g) kulturat e indeve bimore, përfshirë kulturat e qelizave, germplazmët, meristemat, klonet nga organizmat kimerë, materiale të vogla shumëzuese;
- gj) polenet e gjalla dhe sporet;
- h) sythat, sythat drunorë, kalemat, shermendet, shartimet.”.

2. Pikat 4, 6 dhe 8 shfuqizohen.

3. Pika 5 ndryshohet si më poshtë:

“5. “Certifikatë fitosanitare” është një dokument zyrtar i lëshuar nga agronomi i Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, që vërteton se një dërgesë plotëson kërkesat fitosanitare.”.

4. Në pikën 11, në fund të fjalisë shtohet togfjalëshi: “dhe agronomi i kontrollit zyrtar pranë Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve”.

5. Pas pikës 13, në fund, shtohet pika 13/1 me këtë përmbajtje:

“13/1 “Kontrolli zyrtar” është monitorimi, mbikëqyrja, kontrolli dhe inspektimi që kryhet nga agronomi i AKVMB-së ose AKU-së.”.

6. Pika 23 ndryshohet si më poshtë:

“23. “Dëmtues” është kërpudha, bakteri, virusi, insekti, nematoda, fitoplazma, bima e dëmshme, si dhe çdo organizëm tjetër i dëmshëm ose potencialisht i dëmshëm për bimët, produktet bimore dhe objektet e tjera.”.

7. Në pikën 25 hiqet togfjalëshi “të cilat kalojnë në zonat e pastra”.

8. Në pikën 26, në fund të fjalisë shtohet togfjalëshi “bimët dhe produktet bimore.”.

9. Pika 36 shfuqizohet.

10. Pikat 40 dhe 41 ndryshohen si më poshtë:

“40. “Zonë” është një territor ose një pjesë e një territori.

41. “Zonë e Mbrojtur nga Dëmtuesit (ZMD)” është një zonë e pastër nga dëmtues të caktuar.”.

11. Pas pikës 41 shtohen pikat: 42, 43, 44, 45, 46, 47, 48, 49, 50, 51, 52 dhe 53, me këtë përmbajtje:

“42. “Operator profesionist” është çdo person i përfshirë profesionalisht dhe me përgjegjësi ligjore për një ose më shumë aktivitete në lidhje me bimët, produktet bimore dhe objektet e tjera si më poshtë:

- a) mbjelljen;
- b) shumimin;
- c) prodhimin, përfshirë rritjen, shumimin dhe mirëmbajtjen;
- ç) importin, lëvizjen brenda territorit të vendit dhe eksportin;
- d) vendosjen në treg.

43. “Operator i regjistruar” është operatori profesionist i regjistruar sipas nenit 6/1 të këtij ligji.

44. “Operator i miratuar” është operatori i regjistruar, i miratuar për përdorimin e vulës në ambalazhet dhe paletat prej druri dhe/ose për lëshimin e “Pasaportës bimore”.

45. “Çrrënjosje” është aplikimi i masave fitosanitare për të eliminuar një dëmtues nga një zonë e infektuar.

46. “Kontrollimi i dëmtuesve” është aplikimi i masave fitosanitare përreth zonës së infektuar për të parandaluar përhapjen e një dëmtuesi.

47. “Autoritet kompetent” është struktura përgjegjëse për mbrojtjen e bimëve në ministri.

48. “Zonë e infektuar” është një zonë e cila përfshin të gjitha bimët që njihen se janë të infektuara nga dëmtuesit, të gjitha bimët që tregojnë simptoma infeksioni nga dëmtuesi dhe të gjitha bimët e tjera që mund të infektohen nga dëmtuesi për shkak të afërsisë së tyre me bimët e infektuara ose një burim i njohur prodhimi me bimë të infektuara, ose bimë të rritura nga ky burim.

49. “Zonë sigurie ose zonë tampon” është një zonë përreth ose ngjitur me një zonë të kufizuar zyrtarisht për qëllime fitosanitare, në mënyrë që të minimizohet mundësia e përhapjes së dëmtuesit të synuar në/ose jashtë zonës së kufizuar, e cila u



nënshtrohet masave fitosanitare ose kontrolleve të tjera, nëse është e nevojshme.

50. “Zonë e shënuar” është zona e infektuar së bashku me zonën e sigurisë.

51. “Regjistri zyrtar” është regjistri ku regjistrohen operatorët profesionistë dhe operatorët e miratuar.

52. “Agjent i kontrollit biologjik” është një organizëm natyror, antagonist ose konkurrent ose një organizëm tjetër, i cili përdoret për kontrollin e dëmtuesve.

53. “Diagnoza e dëmtuesve” është procesi i zbulimit dhe identifikimit të një dëmtuesi.”

Neni 3

Në nenin 4, pikat 2 dhe 3 ndryshohen si më poshtë:

“2. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit është përgjegjës për administrimin dhe kontrollin në Pikat e Inspektimit Kufitar dhe kryerjen e kontrolleve brenda vendit, sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe të akteve nënligjore që rrjedhin prej tij.

3. Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve është përgjegjës për kontrollin zyrtar të shëndetit të bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera, si dhe për kontrollin e përdorimit të produkteve të mbrojtjes së bimëve, objekt i këtij ligji. Organizimi dhe funksionimi i tij përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit.”

Neni 4

Në nenin 5, në pikën 1.1, pas shkronjës “c” shtohet shkronja “ç” me këtë përmbajtje:

“ç) të hartojë protokollet diagnostike të dëmtuesve në gjuhën shqipe, sipas protokolleve të Konventës Ndërkombëtare të Mbrojtjes së Bimëve (IPPC) dhe Organizatës Evropiane dhe Mesdhetare për Mbrojtjen e Bimëve (EPPO), të cilat miratohen me urdhër të ministrit.”

Neni 5

Pas nenit 6 shtohet neni 6/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 6/1

Regjistri i operatorëve profesionistë

Regjistri i operatorëve profesionistë mbahet në AKVMB. Formati, kriteret dhe procedura e regjistrimit përcaktohen me udhëzim të ministrit.”

Neni 6

Në nenin 7 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Titulli i nenit bëhet “Detyrimi për kontrollin e dëmtuesve”.

2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Lëvizja e bimëve për mbjellje brenda territorit të Republikës së Shqipërisë bëhet vetëm nëse ato janë të pajisura me “Pasaportë bimore”.”

3. Në pikën 5 togfjalëshi “Certifikatë fitosanitare ose” hiqet.

4. Pika 6 ndryshohet si më poshtë:

“6. Kur prania e një dëmtuesi karantinor konfirmohet zyrtarisht në territorin e Republikës së Shqipërisë, ministri me urdhër miraton planin e veprimit ku përcaktohen masat për çrrënjosjen e këtij dëmtuesi.”

5. Pika 7 ndryshohet si më poshtë:

“7. Ministri me urdhër miraton Planin e Monitorimit për dëmtuesit.”

6. Pas pikës 7 shtohen pikat 8 dhe 9, me këtë përmbajtje:

“8. Ministri me urdhër miraton procedurat e marrjes së mostrave.

9. Ministri me urdhër miraton Planin e Monitorimit të mbetjeve të pesticideve.”

Neni 7

Në nenin 9, në pikën 1, togfjalëshi “Certifikatë fitosanitare” zëvendësohet me togfjalëshin “Pasaportë bimore”.

Neni 8

Në nenin 10, pas pikës 3, shtohen pikat 4 dhe 5 me këtë përmbajtje:

“4. Miratimi i Planit të Veprimit (PV) dhe Ushtrimeve të Simulimit bëhet me urdhër të ministrit.

5. Lista e zonave të mbrojtura, e bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera, si dhe



kërkesat përkatëse për të hyrë dhe lëvizur në këto zona përcaktohen në rregulloren e miratuar sipas pikës 3, të nenit 14 të këtij ligji.”.

Neni 9

Në nenin 11 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 1, në fund të fjalisë fjala “dezinfektim” zëvendësohet me togfjalëshin “për qëllime trajtimi dhe vulosjeje, sipas përcaktimeve të pikës 4 të këtij neni”.

2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Materiali i ambalazhit dhe i paletave prej druri lejohet të hyjë dhe të lëvizë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë vetëm nëse plotëson rregullat dhe masat e përcaktuara në rregulloren e miratuar sipas pikës 4 të këtij neni.”.

3. Në pikën 3 pas togfjalëshit “çdo ngarkesë ” shtohet togfjalëshi “në import”.

Neni 10

Neni 12 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 12

Pasaporta bimore

1. Bimët, produktet bimore dhe objektet e tjera lejohen të lëvizin brenda territorit të Republikës së Shqipërisë të shoqëruara me “Pasaportë bimore”.

2. “Pasaporta bimore” lëshohet nga operatori i miratuar, pasi plotësohen kushtet dhe kriteret e miratuara, sipas pikës 5 të këtij neni.

3. Operatori i miratuar lëshon “Pasaportë bimore” vetëm për bimët për të cilat ai është përgjegjës. Ky proces mbikëqyret nga Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

4. Përjashtimisht nga pika 3 e këtij neni, “Pasaportë bimore” lëshohet nga Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, në të gjitha rastet, kur nuk ka operatorë të miratuar.

5. Ministri me urdhër përcakton procedurën, kushtet dhe kriteret që duhet të plotësojë një operator për t’u miratuar për lëshimin e “Pasaportës bimore”, si dhe rastet e heqjes së miratimit.

6. Lista e bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera për të cilat kërkohet një “Pasaportë bimore” përcaktohen në rregulloren e miratuar sipas pikës 3, të nenit 14, të këtij ligji.”.

Neni 11

Titulli i kreut IV ndryshohet dhe bëhet “Shërbimi dhe inspektimi fitosanitar”.

Neni 12

Neni 14 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 14

Detyrimi për inspektimin dhe kontrollin fitosanitar

1. Importi dhe kalimi tranzit i bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera në territorin e Republikës së Shqipërisë bëhen në pikat kufitare të hyrjes ku funksionon kontrolli fitosanitar dhe i nënshtrohen inspektimit.

2. Inspektori i kontrollit fitosanitar është pjesë e grupit të punonjësve doganorë që marrin kontaktin e parë me mjetet që transportojnë bimë, produkte bimore, PMB dhe objekte të tjera.

3. Ministri miraton me rregullore masat mbrojtëse kundër dëmtuesve të bimëve.

4. Ndalohet importi, eksporti dhe kalimi tranzit i bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera të infektuara me dëmtues karantinorë, të përcaktuar sipas pikës 3 të këtij neni.

5. Ndalohet importi dhe lëvizja e bimëve për mbjellje brenda territorit të Republikës së Shqipërisë nëse prania e dëmtuesve jokarantinorë të rregulluar ose simptomat e shkaktuara nga dëmtues jokarantinorë të rregulluar janë mbi kufijtë kritikë, të përcaktuar sipas pikës 3 të këtij neni.

6. Lejohet importi, eksporti dhe përdorimi i agentëve të kontrollit biologjik, që janë pjesë e listës, sipas pikës 7 të këtij neni.

7. Lista e agentëve të kontrollit biologjik në territorin e Republikës së Shqipërisë përcaktohet me urdhër ministri.

8. Tarifat e shërbimit për kontrollin fitosanitar në pikat e kalimit kufitar ku funksionon kontrolli fitosanitar dhe për kontrollin e shëndetit të bimëve në territorin e Republikës së Shqipërisë përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit të bujqësisë dhe financave. Në rastin e marrëveshjeve ndërkombëtare dypalëshe ose shumëpalëshe, mund të mos aplikohen tarifa.

9. Në rastin e marrëveshjeve ndërkombëtare dypalëshe ose, kontrolli dhe inspektimi fitosanitar,



sipas këtij neni, për importin e bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera kryhet jashtë pikës kufitare të hyrjes, në terminalin e doganës.”.

Neni 13

Në nenin 15 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pikat 1, 2 dhe 3 ndryshohen si më poshtë:

“1. Operatorët profesionistë, kur vërejnë ose dyshojnë për një dëmtues karantinor të pahasur më parë në një zonë, ose për shtimin masiv të një dëmtuesi, janë të detyruar të njoftojnë menjëherë Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

2. Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve mund të vendosë që njoftimi i përmendur në pikën 1 të këtij neni të mos kërkohet kur një dëmtues specifik është hasur në atë zonë. Në këtë rast informohen operatorët profesionistë për këtë vendim.

3. Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, pas përcaktimit të parregullsisë apo dëmtuesve ose shfaqjes së një dëmtuesi karantinor, njofton menjëherë autoritetin kompetent. Në rastet e përcaktimit të parregullsisë apo dëmtuesve ose shfaqjes së një dëmtuesi karantinor në zona të shpallura të mbrojtura sipas legjislacionit në fuqi të zonave të mbrojtura, njofton edhe strukturën përgjegjëse që mbulon fushën e zonave të mbrojtura.”.

2. Pas pikës 3, shtohen pikat 4 dhe 5 me këtë përmbajtje:

“4. Inspektori i kontrollit fitosanitar në pikën e inspektimit kufitar, pas përcaktimit të parregullsisë apo dëmtuesit në ngarkesat që janë objekt inspektimi fitosanitar në import, njofton autoritetin kompetent të vendit të origjinës dhe autoritetin kompetent.

5. Rregullat dhe formati për mënyrën e njoftimit përcaktohen me udhëzim të ministrit.”.

Neni 14

Neni 16 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 16

Shpallja e zonës së shënuar

1. SPMB-ja përgatit masat për kufizimin e përhapjes së dëmtuesit karantinor deri në

çrrënjësien e tij në zonën përkatëse dhe i propozon ministrit miratimin e këtyre masave dhe shpalljen e kësaj zone si zonë të shënuar.

2. Shpallja e zonës së shënuar dhe masat për kufizimin e përhapjes së dëmtuesit karantinor përcaktohen me urdhër të ministrit dhe u njoftohen organeve të vetëqeverisjes vendore dhe operatorëve profesionistë.”.

Neni 15

Në nenin 18 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 1, në shkronjat “a” dhe “b”, togfjalëshi “të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë” hiqet.

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Formatit dhe përmbajtja e certifikatave fitosanitare, ku përcaktohet edhe qëllimi i përdorimit, janë të përcaktuara në rregulloren sipas pikës 3, të nenit 14, të këtij ligji.”.

Neni 16

Në nenin 19, në fund të pikës 5 shtohet togfjalëshi “sipas propozimit të strukturës përgjegjëse për mbrojtjen e bimëve”.

Neni 17

Në nenin 28, në pikën 1 bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja “b” ndryshon si më poshtë:

“b) gjobë 50 000 lekë në rastet kur veprohet në kundërshtim me nenin 6/1; me pikën 2, të nenit 7; pikën 1, të nenit 10; nenin 11; pikën 1, të nenit 12; pikat 4, 5 dhe 6, të nenit 14; pikën 1, të nenit 17 dhe pikën 4, të nenit 22, të këtij ligji;”.

2. Shkronja “c” ndryshon si më poshtë:

“c) gjobë 100 000 lekë në rastet kur veprohet në kundërshtim me pikat 2 e 6, të nenit 20; nenin 21; pikat 2 e 3, të nenit 23 dhe pikën 4, të nenit 24, të këtij ligji;”.

Neni 18

1. Ngarkohet ministri përgjegjës për bujqësinë që, brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 5, pika 1.1, shkronja “ç”; nenit 6/1; nenit 7, pikat 6, 7, 8 dhe 9; nenit 10, pika 4; nenit 12, pika 5; nenit 14,



pikat 3 dhe 7; nenit 15, pika 5, dhe nenit 16, pika 2, të ligjit.

2. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda një viti pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, të nxjerrë aktin nënligjor në zbatim të nenit 12 të ligjit.

Neni 19

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 3.2.2022.

Shpallur me dekretin nr.13493, datë 25.2.2022, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

DEKRET

Nr. 13493, datë 25.2.2022

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 15/2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 105/2016 ‘Për mbrojtjen e bimëve’”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

LIGJ
Nr. 17/2022

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE MBRETËRISË SË SPANJËS, SI SHITESË E KONVENTËS EVROPIANE PËR EKSTRADIMIN, TË VITIT 1957

Në mbështetje të neneve 81, pika 1, dhe 100 të Kushtetutës, si dhe të nenit 17, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVEND

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Spanjës, si shtesë e Konventës Evropiane për Ekstradimin, të vitit 1957, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 17.2.2022.

Shpallur me dekretin nr.13494, datë 25.2.2022, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

MARRËVESHJE

NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE MBRETËRISË SË SPANJËS, SI SHITESË
E KONVENTËS EVROPIANE
PËR EKSTRADIMIN, TË VITIT 1957

Mbretëria e Spanjës dhe Republika e Shqipërisë, në vijim të referuara si “Palët”;

me dëshirën për të ruajtur dhe forcuar lidhjet e tyre ligjore dhe gjyqësore;

me dëshirën për të përmirësuar procedurat e ekstradimit, në përputhje me legjislacionin dhe rregulloret e vendit, lidhur me dorëzimin e ndërsjellë të autorëve të veprave penale;

me dëshirën për të plotësuar dispozitat e Konventës Evropiane për Ekstradimin, të 13 dhjetorit 1957 (Konventa Evropiane për Ekstradimin) dhe për të lehtësuar zbatimin e saj ndërmjet Palëve, veçanërisht në lidhje me ekstradimin e shtetasve të tyre përkatës;

ndërsa, në lidhje me ekstradimin e shtetasve, qeveria e Republikës së Shqipërisë, kur ka depozituar instrumentin e saj të ratifikimit të Konventës Evropiane për Ekstradimin, ka deklaruar, duke iu referuar dispozitës së parashikuar nga neni 6 (1) i Konventës në fjalë, se:



“Republika e Shqipërisë refuzon ekstradimin e shtetasve të saj, me përjashtim të rasteve kur është e parashikuar ndryshe në marrëveshje ndërkombëtare ku Shqipëria është palë”,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Ekstradimi i shtetasve

Palët bien dakord të ekstradojnë reciprokisht shtetasit e tyre, me qëllim ndjekjen penale për kryerjen e veprave penale, për ekzekutimin e një dënimi ose zbatimin të një mase sigurimi, në përputhje me dispozitat e Konventës Evropiane për Ekstradimin.

Palët bien dakord se shtetësia nuk do të jetë pengesë për ekstradimin e shtetasve të tyre.

Neni 2

Kanalet e komunikimit

1. Palët caktojnë Ministrinë e Drejtësisë të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrinë e Drejtësisë të Mbretërisë së Spanjës si Autoritete Qendrore kompetente për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

2. Autoritetet Qendrore komunikojnë drejtpërdrejt me njëri-tjetrin, duke u përpjekur që të përdorin teknologji të reja, me qëllim zgjidhjen e ndonjë çështjeje që mund të dalë gjatë përpunimit të kërkesave të ekstradimit.

3. Pavarësisht nga sa më sipër, Palët mund të përdorin kanale diplomatike për dërgimin ose marrjen e kërkesave të ekstradimit, ose informacion në lidhje me zbatimin e tyre, kur e çmojnë të nevojshme për shkak të rrethanave të veçanta të çështjes.

Neni 3

Zbatimi i përkohshëm

1. Kjo Marrëveshje zbatohet për vepra penale të kryera para ose pas datës së hyrjes në fuqi.

2. Kjo Marrëveshje nuk zbatohet për kërkesat e ekstradimit të marra para datës së hyrjes në fuqi.

3. Në rast të përfundimit të kësaj Marrëveshjeje, kërkesat e ekstradimit të marra para datës kur Marrëveshja nuk është më në fuqi do të vazhdojnë të rregullohen nga kjo Marrëveshje pavarësisht përfundimit të saj.

Neni 4

Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje lidhet për një afat kohor të pacaktuar dhe hyn në fuqi në datën e njoftimit të fundit mbi përfundimin e procedurave të brendshme nga Palët.

Neni 5

Vlefshmëria dhe përfundimi

Kjo Marrëveshje mund të përfundohet nga secila Palë, në çdo kohë, duke njoftuar përmes kanaleve diplomatike. Ky përfundim hyn në fuqi gjashtë muaj pas datës së njoftimit përmes kanaleve diplomatike.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, përfaqësuesit e autorizuar, sipas rregullave nga qeveritë e tyre përkatëse, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Nënshkruar në dy kopje, në Madrid, në datën 4 tetor 2021, në gjuhën shqipe, spanjolle dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njëllorj autentike.

PËR REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Edi Rama

Kryeministër

PËR MBRETËRINË E SPANJËS

Pedro Sánchez Pérez-Castejón

Kryeministër

DEKRET

Nr. 13494, datë 25.2.2022

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 17/2022 “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Spanjës, si shtesë e Konventës Evropiane për Ekstradimin të vitit 1957”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË

Ilir Meta



LIGJ
Nr. 18/2022

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË NË KONVENTËN
KUADËR PËR ETIKËN NË TURIZËM
DHE PROTOKOLLIN OPSIONAL TË SAJ

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në Konventën Kuadër për Etikën në Turizëm dhe protokollin opsional të saj, bërë në Shën Petërsburg, Federata Ruse, në datën 12–17 shtator 2019, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 17.2.2022.

Shpallur me dekretin nr. 13495, datë 25.2.2022, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

Përmbajtja

KONVENTË KUADËR PËR ETIKËN NË
TURIZËM DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1. Përkufizime

Neni 2. Qëllimi dhe objekti

Neni 3. Mjetet e zbatimit

PARIMET ETIKE NË TURIZËM

Neni 4. Kontributi i turizmit në mirëkuptimin reciprok dhe respektin ndërmjet popujve dhe shoqërive

Neni 5. Turizmi si mjet për përmbushjen individuale dhe kolektive

Neni 6. Turizmi, një faktor qëndrueshmërie mjedisore

Neni 7. Turizmi, një përdorues i burimeve kulturore dhe kontribues në rritjen e tyre

Neni 8. Turizmi, një aktivitet i dobishëm për vendet dhe komunitetet pritëse

Neni 9. Përgjegjësitë e aktorëve në zhvillimin e turizmit

Neni 10. E drejta për turizëm

Neni 11. Liria e lëvizjes së turistëve

Neni 12. Të drejtat e të punësuarve dhe të profesionistëve në sektorin e turizmit

KOMITETI BOTËROR PËR ETIKËN NË
TURIZËM

Neni 13. Mandati

Neni 14. Përbërja

Neni 15. Funksionimi

KONFERENCA E SHTETEVE PALË

Neni 16. Përbërja dhe përgjegjësitë

Neni 17. Sekretariati

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 18. Nënshkrimi

Neni 19. Ratifikimi, pranimi, aprovimi ose aderimi

Neni 20. Hyrja në fuqi

Neni 21. Ndryshimi i Konventës

Neni 22. Denoncimi

Neni 23. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Neni 24. Tekstet autentike

Neni 25. Depozituesi

Neni 26. Regjistrimi

PROTOKOLLI OPSIONAL I KONVEN-
TËS KUADËR PËR ETIKËN NË TURIZËM

KONVENTË KUADËR PËR ETIKËN
NË TURIZËM

Palët e Larta Kontraktuese,

me dëshirën për të zhvilluar turizmin, me qëllim dhënien e kontributit në zhvillimin ekonomik, mirëkuptimin ndërkombëtar, paqen, përparimin dhe respektimin universal dhe marrjen parasysh të të drejtave dhe lirive të njeriut për të gjithë dhe pa dallim të asnjë lloji, si: raca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, bindjet politike ose të tjera, origjina kombëtare ose sociale, prona, mosha, statusi i lindjes apo tjetër;

duke marrë parasysh që turizmi ka potencial për të kontribuar drejtpërdrejt ose jodrejtpërdrejt në Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Agjendës



2030, për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe, në veçanti, në lidhje me rritjen ekonomike gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, punësimin e plotë dhe produktiv dhe punën e denjë për të gjithë, konsumin dhe prodhimin e qëndrueshëm dhe përdorimin e qëndrueshëm të oqeanëve dhe të burimeve detare dhe ekosistemit tokësor;

duke besuar fort se, përmes kontakteve të drejtpërdrejta, spontane dhe jo të ndërmjetësuar që krijon ndërmjet burrave dhe grave të kulturave dhe stileve të ndryshme të jetës, turizmi përfaqëson një forcë jetësore për paqen dhe një faktor miqësie dhe mirëkuptimi ndërmjet popujve në botë;

në pajtim me arsyetimin e ndërthurjes së mbrojtjes së mjedisit, zhvillimit ekonomik dhe luftës kundër varfërisë në një mënyrë të qëndrueshme, siç është formuluar nga Kombet e Bashkuara në vitin 1992 në “Samitin e Tokës” të Rio de Janeiro, e shprehur në Agjendën 21, miratuar me atë rast dhe përsëritur nga “Samitet e Tokës” të Johannesburgut në vitin 2002 dhe Rio në vitin 2012 (Rio + 20);

duke marrë parasysh rritjen e shpejtë dhe të vazhdueshme, si të kaluar dhe të parashikueshme, të aktivitetit turistik, qoftë për kohën e lirë, biznesin, kulturën, qëllimet fetare ose shëndetësore dhe produkte dhe segmente të tjera të interesit të veçantë të turizmit, dhe efektet e tij të fuqishme, si pozitive ashtu edhe negative, mbi mjedisin, ekonominë dhe shoqërinë e vendit gjenerues dhe pritës, mbi komunitetet lokale dhe popujve autoktonë, si dhe mbi marrëdhëniet ndërkombëtare dhe shkëmbimet;

me synimin për të promovuar një turizëm të përgjegjshëm, të qëndrueshëm dhe të ofrueshëm në të gjithë botën, në kuadrin e së drejtës së të gjithë personave për të përdorur kohën e tyre të lirë për qëllime argëtimi ose udhëtime, duke respektuar zgjedhjet e shoqërisë së të gjithë popujve;

plotësisht të bindur se, me kusht që të respektohen një numër parimesh dhe një numër i caktuar rregullash, turizmi i përgjegjshëm dhe i qëndrueshëm nuk është aspak i papajtueshëm me liberalizimin në rritje të kushteve që rregullojnë sigurimin e mallrave dhe shërbimeve dhe në respektim të të cilave veprojnë ndërmarrjet e këtij sektori, dhe, në këtë kontekst, është e nevojshme të gërshetohet mjedisi me zhvillimin ekonomik dhe shoqëror, hapjen ndaj tregtisë ndërkombëtare me mbrojtjen e identiteteve shoqërore dhe kulturore;

duke marrë parasysh që, me një qasje të tillë, të gjithë aktorët në zhvillimin e turizmit - administratat kombëtare, rajonale dhe lokale, ndërmarrjet, shoqatat e biznesit, punëtorët në sektor, organizatat joqeveritare dhe organet e të gjitha llojeve që lidhen me sektorin e turizmit, si dhe komunitetet pritëse, media dhe vetë turistët, përfshirë ekskursionistët – kanë përgjegjësi të ndryshme megjithëse të ndërvarura në zhvillimin individual dhe shoqëror të turizmit dhe që formulimi i të drejtave dhe i detyrave të tyre individuale do të kontribuojë në përmbushjen e këtij qëllimi;

duke theksuar se, edhe në fushën e turizmit, si Shteti ashtu edhe ndërmarrjet ndajnë përgjegjësinë e intensifikimit të mbrojtjes dhe të respektimit të të drejtave të njeriut në kontekstin e biznesit, siç përcaktohet nga Parimet Udhëzuese për Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut të miratuara unanimisht nga Këshilli i të Drejtave të Njeriut të OKB-së në rezolutën e tij 17/4 të 16 qershorit 2011;

duke iu referuar konventave të miratuara nga Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO), që mbulojnë temat që konsiderohen, si parime themelore dhe të drejtat në punë: liria e krijimit të shoqatave dhe njohja efektive e së drejtës për negociata kolektive; eliminimi i punës së detyruar ose të detyrueshme; heqja e punës së fëmijëve; eliminimi i diskriminimit në lidhje me punësimin dhe profesionin;

duke kujtuar rezolutën A/RES/406 (XIII) të vitit 1999 të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës Botërore të Turizmit (më poshtë e referuar si “OBTKB”) me të cilën ajo miratoi solemnisht Kodin Global të Etikës për Turizmin;

duke kujtuar rezolutën A/RES/668 (XXI) të vitit 2015, ku Asambleja e Përgjithshme e OBTKB-së shprehu dëshirën e saj për ta shndërruar Kodin Global të Etikës për Turizmin në një traktat ligjërisht të detyrueshëm për të forcuar efektivitetin e tij në nivelin ndërkombëtar dhe kombëtar;

duke marrë parasysh që Komiteti Botëror për Etikën në Turizëm (më poshtë i referuar si “Komiteti”), i themeluar në vitin 2001, në bazë të rezolutës A/RES/438 (XIV), është një organ ndihmës i Asamblesë së Përgjithshme të OBTKB-së;

të bindur se kjo Konventë Kuadër (më poshtë e referuar si “Konventa”) do të intensifikojë përparimin e një turizmi më të qëndrueshëm dhe



etik, siç shprehet në Kodin Global të Etikës për Turizmin;

me qëllim plotësimin e kësaj Konvente Kuadër me një Protokoll Opsional, i cili është një instrument ligjor i veçantë dhe i pavarur i hapur për Shtetet Palë në këtë Konventë, duke parashikuar një proces për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, që mund të orientojë dhe të forcojë zbatimin e parimeve etike nga të gjithë palët e interesuara;

të frymëzuar nga rezolutat dhe vendimet, në lidhje me zbatimin e Kodit Global të Etikës për Turizmin, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OBTKB-së dhe Këshilli Ekzekutiv;

duke riafirmuar se, si një agjenci e specializuar e Kombeve të Bashkuara, OBTKB-ja, si dhe Shtetet Anëtare të saj, orientohet në aktivitetet e saj nga Karta e Kombeve të Bashkuara, rezolutat përkatëse të Kombeve të Bashkuara dhe normat dhe parimet e pranuar përgjithësisht të së drejtës ndërkombëtare,

kanë rënë dakord si më poshtë:

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Përkufizime

Për qëllimet e kësaj Konvente dhe nëse nuk parashikohet ndryshe në dispozita të veçanta, zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

a) “parimet etike në turizëm” janë parimet e përcaktuara në këtë Konventë në nenet 4 deri 12 më poshtë;

b) “turizmi” u referohet aktiviteteve të vizitorëve, qofshin turistë apo ekskursionistë;

c) “turist” është një person që bën një udhëtim që përfshin një fjetje në një destinacion kryesor jashtë mjedisit të tij/saj të zakonshëm, për më pak se një vit, për një qëllim parësor (biznes, kohë të lirë ose qëllim tjetër personal), përveçse të punësohet nga një subjekt me qëndrim në shtetin ose vendin e vizituar;

d) ekskursionist është një person që bën një udhëtim, i cili nuk përfshin një fjetje në një destinacion kryesor jashtë mjedisit të tij/saj të zakonshëm. Për qëllimet e kësaj Konvente, çdo referencë për turistët përbën në të njëjtën kohë një referencë për ekskursionistët;

e) palët e interesuara në zhvillimin e turizmit përfshijnë:

- i. qeveritë e shteteve;
- ii. pushteti lokal me kompetencë specifike në çështjet e turizmit;
- iii. institucionet e turizmit dhe ndërmarrjet e turizmit, përfshirë shoqatat e tyre;
- iv. institucionet e angazhuara në financimin e projekteve turistike;
- v. punonjësit dhe profesionistët e turizmit;
- vi. sindikatat e punonjësve të turizmit;
- vii. turistët dhe ekskursionistët;
- viii. popullatat lokale dhe komunitetet pritëse në destinacionet turistike përmes përfaqësuesve të tyre; dhe
- ix. persona të tjerë juridikë dhe fizikë, që kanë aksione në zhvillimin e turizmit, duke përfshirë organizatat joqeveritare të specializuara në turizëm dhe të përfshira direkt në projekte turistike dhe ofrimin e shërbimeve të turizmit;
- f) burimet e turizmit janë burimet natyrore dhe kulturore, që kanë potencialin për të tërhequr turistë.

Neni 2

Qëllimi dhe objekti

1. Kjo Konventë synon të promovojë një turizëm të përgjegjshëm, të qëndrueshëm dhe të arritshëm në mënyrë universale përmes zbatimit të parimeve etike në turizëm.

2. Kjo Konventë u referohet të gjithë aktorëve në zhvillimin e turizmit brenda kuptimit të nenit 1(e) në respektimin e parimeve etike në turizëm.

Neni 3

Mjetet e zbatimit

1. Shtetet Palë promovojnë turizmin e përgjegjshëm, të qëndrueshëm dhe të arritshëm në mënyrë universale, duke hartuar politika që janë në përputhje me parimet etike në turizëm të përcaktuara në Konventë.

2. Shtetet Palë respektojnë dhe promovojnë parimet etike në turizëm, veçanërisht përmes inkurajimit të ndërmarrjeve dhe të strukturave të turizmit, që pasqyrojnë këto parime në instrumentet e tyre kontraktuale dhe t'u referohen atyre në kodet e tyre të sjelljes ose rregullat profesionale.

3. Shtetet Palë i paraqesin një raport periodik Komitetit Botëror të Etikës në Turizëm, në lidhje



me çdo masë të marrë ose të parashikuar për zbatimin e kësaj Konvente.

4. Shtetet Palë, të cilat janë, gjithashtu, palë në Protokollin Opsional të Konventës Kuadër mbi Etikën në Turizëm, promovojnë ndërmjet ndërmarrjeve dhe organeve të turizmit mekanizmin e pajtimit të parashikuar në Protokollin Opsional.

PARIMET ETIKE NË TURIZËM

Neni 4

Kontributi i turizmit në mirëkuptimin reciprok dhe respektin ndërmjet popujve dhe shoqërive

1. Kuptimi dhe promovimi i vlerave etike të përbashkëta për njerëzimin, me një qëndrim tolerance dhe respekti ndaj larmisë së besimeve fetare, filozofike dhe morale, janë të dyja themeli dhe pasoja e turizmit të përgjegjshëm; palët e interesuara në zhvillimin e turizmit dhe vetë turistët duhet të vëzhgojnë traditat dhe praktikatat shoqërore dhe kulturore të të gjithë popujve, përfshirë ato të pakicave dhe të popujve autoktonë dhe të njohin vlerën e tyre.

2. Aktivitetet e turizmit duhet të zhvillohen në harmoni me atributet dhe traditat e rajoneve dhe të vendeve pritëse dhe në respekt të ligjeve, praktikave dhe zakoneve të tyre.

3. Komunitetet pritëse, nga njëra anë, dhe profesionistët vendës, nga ana tjetër, duhet të njihen dhe të respektojnë turistët që i vizitojnë ata dhe të mësojnë për stilin e jetës, shijet dhe pritshmëritë e tyre; edukimi dhe trajnimi i dhënë profesionistëve kontribuon në një pritje mikpritëse.

4. Është detyrë e autoriteteve publike të sigurojnë mbrojtje edhe për turistët dhe sendet e tyre; ato duhet t'i kushtojnë vëmendje sigurisë së turistëve të huaj; nëse është e nevojshme, ata duhet të lehtësojnë futjen e mjeteve të informacionit, parandalimit, sigurisë, sigurimeve dhe ndihmës, në përputhje me nevojat e tyre; çdo goditje, sulm, rrëmbim ose kërcënim kundër turistëve ose punëtorëve në industrinë e turizmit, si dhe shkatërrimi i qëllimshëm i objekteve të turizmit ose i elementeve të trashëgimisë kulturore ose natyrore duhet të dënohen dhe të ndëshkohen ashpër, në përputhje me ligjet e tyre përkatëse kombëtare.

5. Kur udhëtojnë, turistët nuk duhet të kryejnë asnjë veprim kriminal ose ndonjë veprim të

konsideruar kriminal nga ligjet e vendit të vizituar dhe të heqin dorë nga çdo sjellje që konsiderohet fyese ose e dëmshme nga popullata lokale, ose që mund të dëmtojë mjedisin lokal; ata duhet të distancohen nga të gjitha trafikimet e drogave të paligjshme, armëve, sendeve antike, specieve të mbrojtura dhe produkteve dhe substancave që janë të rrezikshme ose të ndaluara nga rregullimet e brendshme.

6. Turistët kanë përgjegjësinë të njihen, madje edhe para nisjes së tyre, me karakteristikat e vendeve që po përgatiten të vizitojnë; ata duhet të jenë të vetëdijshëm për rreziqet shëndetësore dhe të sigurisë të natyrshme në çdo udhëtim jashtë mjedisit të tyre të zakonshëm dhe të sillen në një mënyrë të tillë që të minimizojnë ato rreziqe.

Neni 5

Turizmi si mjet për përmbushjen individuale dhe kolektive

1. Turizmi, aktiviteti që shoqërohet më shpesh me pushimin dhe çlodhjen, sportin dhe qasjen në kulturë dhe natyrë, duhet të planifikohet dhe të praktikohet si një mjet i privilegjuar i përmbushjes individuale dhe kolektive; kur praktikohet me një mendje mjaft të hapur, është një faktor i pazëvendësueshëm i vetësigurimit, tolerancës reciproke dhe për të mësuar në lidhje me ndryshimet legjitime ndërmjet popujve dhe kulturave dhe larminë e tyre.

2. Aktivitetet turistike duhet të respektojnë barazinë ndërmjet burrave dhe grave; ato duhet të promovojnë të drejtat e njeriut dhe, posaçërisht, të drejtat individuale të grupeve më të rrezikuara, veçanërisht fëmijët, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, pakicat etnike dhe popujt autoktonë.

3. Shfrytëzimi i qenieve njerëzore në çdo formë, veçanërisht seksual, sidomos kur zbatohet te fëmijët, bie ndesh me qëllimet themelore të turizmit dhe është mohim i turizmit; si i tillë, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, duhet të luftohet energjikisht me bashkëpunimin e të gjitha shteteve të interesuara dhe të penalizohet pa mëdyshje nga legjislacioni kombëtar si i vendeve të vizituara, ashtu edhe i vendeve të autorëve të këtyre veprimeve, edhe kur ato kryhen jashtë vendit.

4. Udhëtimi për qëllime shëndetësore, arsimore dhe shkëmbime shpirtërore, kulturore ose



gjuhësore është, veçanërisht, i dobishëm dhe meriton inkurajim.

5. Futja në programin arsimor i vlerave të shkëmbimeve turistike, përfitimeve ekonomike, sociale dhe kulturore, si dhe rreziqet e tyre, duhet të inkurajohet.

Neni 6

Turizmi, një faktor qëndrueshmërie mjedisore

1. Të gjithë aktorët e interesuar në zhvillimin e turizmit duhet të ruajnë mjedisin natyror me synimin për të arritur një rritje të shëndoshë, të vazhdueshme dhe të qëndrueshme ekonomike, të përshtatur për të kënaqur në mënyrë të barabartë nevojat dhe aspiratat e brezave të tanishëm dhe të ardhshëm.

2. Të gjitha format e zhvillimit të turizmit që janë të favorshme për kursimin e burimeve të rralla dhe të çmuara natyrore, në veçanti të ujit dhe energjisë, si dhe shmangien sa më shumë të jetë e mundur të prodhimit të mbetjeve, duhet t'u jepet përparësi dhe të inkurajohen nga autoritetet publike kombëtare, rajonale dhe lokale.

3. Duhet të synohet lëvizja në kohë dhe në hapësirë e flukseve turistike, veçanërisht e atyre që rezultojnë nga pushimet e paguara dhe pushimet shkollore, si dhe shpërndarja më e barabartë e pushimeve, në mënyrë që të ulët presioni i aktivitetit të turizmit në mjedis dhe të rritet ndikimi i tij i dobishëm në industrinë turistike dhe ekonominë lokale.

4. Infrastruktura e turizmit duhet të projektohet dhe aktivitetet turistike të programohen në mënyrë të tillë, që të mbrojnë trashëgiminë natyrore të përbërë nga ekosistemet dhe biodiversitetin dhe të ruajnë speciet e rrezikuara të jetës së egër; palët e interesuara në zhvillimin e turizmit dhe, veçanërisht profesionistët, duhet të bien dakord për vendosjen e kufizimeve ose të pengesave në aktivitetet e tyre, kur ato ushtrohen në zona, veçanërisht të ndjeshme: shkretëtira, rajone polare ose malore të larta, zona bregdetare, pyje tropikale ose ligatina, të favorshme për krijimin e rezervateve natyrore ose zonave të mbrojtura.

5. Turizmi natyror dhe ekoturizmi njihen si veçanërisht të favorshëm për pasurimin dhe përmirësimin e gjendjes së turizmit, me kusht që të respektojnë trashëgiminë natyrore dhe popullatat

lokale dhe të jenë në përputhje me kapacitetin mbajtës të vendeve.

Neni 7

Turizmi, një përdorues i burimeve kulturore dhe kontribues në rritjen e tyre

1. Burimet e turizmit janë elemente themelore të civilizimit dhe të kulturës së popujve; banorët, në territoret e të cilëve ato janë, kanë të drejta dhe detyrime të veçanta ndaj tyre.

2. Politikat dhe aktivitetet e turizmit duhet të zhvillohen duke respektuar trashëgiminë artistike, arkeologjike dhe kulturore, të cilën ata duhet ta mbrojnë dhe t'u kalojnë brezave të ardhshëm; një kujdes i veçantë duhet t'i kushtohet ruajtjes së monumenteve, vendeve të kultit, vendeve arkeologjike dhe historike, si dhe azhurnimit të muzeve, të cilat duhet të jenë gjerësisht të hapura dhe të arritshme për vizitat turistike; nuk duhet të vendosen pengesa të tepërta për hyrjen e publikut në pasuri kulturore dhe monumente në pronësi private, në lidhje me të drejtat e pronarëve të tyre, si dhe vendet e kultit, duke mos cenuar nevojat normale për lutje.

3. Burimet financiare që rrjedhin nga vizitat në vendet kulturore dhe monumentet, të paktën pjesërisht, duhet të përdoren për mirëmbajtjen, mbrojtjen, zhvillimin dhe zbukurimin e kësaj trashëgimie.

4. Aktiviteti i turizmit duhet të planifikohet në një mënyrë të tillë që të lejojë që produktet tradicionale kulturore, zanatet dhe folklori të mbijetojnë dhe të lulëzojnë, dhe jo të detyrohen të degjenerojnë dhe të standardizohen.

Neni 8

Turizmi, një aktivitet i dobishëm për vendet dhe komunitetet pritëse

1. Popullatat lokale duhet të angazhohen në aktivitete turistike dhe të marrin pjesë në mënyrë të drejtë në përfitimet ekonomike, sociale dhe kulturore që ato gjenerojnë dhe, veçanërisht, në krijimin e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë të vendeve të punës që rezultojnë prej tyre.

2. Politikat e turizmit duhet të zbatohen në mënyrë të tillë, që të ndihmojnë në ngritjen e standardit të jetesës së popullatave të rajoneve të vizituara dhe plotësimin e nevojave të tyre;



planifikimi dhe qasja arkitektonike, si dhe funksionimi i vendeve turistike dhe akomodimi duhet të synojnë t'i integrojnë ato, për aq sa është e mundur, në strukturën ekonomike dhe sociale lokale; aty ku aftësitë janë të barabarta, përparësi duhet t'i jepet fuqisë punëtore lokale.

3. Vëmendje e veçantë duhet t'u kushtohet problemeve specifike të zonave bregdetare dhe territoreve ishuj dhe rajoneve të rrezikuara rurale ose malore, për të cilat turizmi shpesh përfaqëson një mundësi të rrallë për zhvillim përballë rënies së aktiviteteve ekonomike tradicionale.

4. Profesionistët e turizmit, veçanërisht investitorët, të qeverisur nga rregullimet e përcaktuara nga autoritetet publike, duhet të kryejnë studime për ndikimin e projekteve të tyre të zhvillimit në mjedis dhe në mjediset kulturore dhe natyrore; ata, gjithashtu, duhet të japin, me transparencën dhe objektivitetin më të madh, informacion mbi programet e tyre të ardhshme dhe pasojat e tyre të parashikueshme dhe të nxisin dialogun për përmbajtjen e tyre me popullatat në fjalë.

Neni 9

Përgjegjësitë e aktorëve në zhvillimin e turizmit

1. Shtetet Palë duhet të sigurojnë që profesionistët e turizmit t'u sigurojnë turistëve informacion objektiv dhe të ndershëm për vendet e tyre të destinacionit dhe për kushtet e udhëtimit, mikpritjes dhe qëndrimit. Profesionistët e turizmit duhet të sigurojnë që dispozitat kontraktuale të propozuara klientëve të tyre të jenë lehtësisht të kuptueshme për sa i përket natyrës, çmimit dhe cilësisë së shërbimeve, që ata angazhohen të sigurojnë dhe kompensimit financiar të pagueshëm prej tyre, në rast të shkeljes së njëanshme të kontratës nga ana e tyre.

2. Profesionistët e turizmit, për aq sa varet prej tyre dhe në bashkëpunim me autoritetet publike, duhet të tregojnë shqetësim për sigurinë dhe qenien të sigurt, parandalimin e aksidenteve, mbrojtjen e shëndetit dhe sigurinë e ushqimit të atyre që kërkojnë shërbimet e tyre; po kështu, ata duhet të sigurojnë ekzistencën e sistemeve të përshtatshme të sigurimeve dhe të ndihmës; ata duhet të pranojnë detyrimet për raportim të parashikuara nga rregullimet e brendshme dhe të paguajnë

kompensim të drejtë, në rast të mosrespektimit të detyrimeve të tyre kontraktuale.

3. Profesionistët e turizmit, për aq sa kjo varet nga ata dhe nëse është e përshtatshme, duhet të kontribuojnë dhe të lejojnë përmbushjen kulturore dhe shpirtërore të turistëve gjatë udhëtimit të tyre.

4. Autoritetet publike të shteteve gjeneruese dhe të vendeve pritëse, në bashkëpunim me profesionistët e interesuar dhe shoqatat e tyre, duhet të sigurojnë vendosjen e mekanizmave të nevojshëm për riatdhësimin e turistëve në çdo rast.

5. Qeveritë kanë të drejtë – dhe detyrë – veçanërisht gjatë një krize, të informojnë shtetasit e tyre për rrethanat e vështira, apo edhe rreziqet që mund të hasin gjatë udhëtimit të tyre jashtë vendit; është gjithmonë përgjegjësia e tyre të japin një informacion të tillë pa dëmtuar në mënyrë të pajustificuar ose të ekzagjeruar sektorin e turizmit në vendet pritëse dhe interesat e operatorëve të tyre; përmbajtja e udhëzuesve të udhëtimit duhet të jetë objekt konsultimi, sipas rastit, me autoritetet e vendeve pritëse; rekomandimet e formuluar duhet të jenë saktësisht proporcionale me rëndësinë e situatave të hasura dhe të kufizuara në zonat gjeografike ku ka lindur pasiguria; këshilltarë të tillë duhet të kualifikohen ose të anulohen menjëherë, sapo këtë ta lejojë kthimi në normalitet.

6. Shtypi dhe, posaçërisht, shtypi i specializuar i udhëtimit dhe mediet e tjera, duke përfshirë mjetet modeme të komunikimit elektronik, duhet të japin informacion të ndershëm dhe të ekuilibruar për ngjarjet dhe situatat që mund të ndikojnë në fluksin e turistëve; ata, gjithashtu, duhet të sigurojnë informacion të saktë dhe të besueshëm për konsumatorët e shërbimeve të turizmit; për këtë qëllim duhet të zhvillohen dhe të përdoren, gjithashtu, teknologjitë e reja të komunikimit dhe tregtisë elektronike; siç është rasti për mediet, ato në asnjë mënyrë nuk duhet të promovojnë shfrytëzimin seksual në turizëm.

Neni 10

E drejta për turizëm

1. Perspektiva e qasjes së drejtpërdrejtë dhe personale në zbulimin dhe shijimin e burimeve të planetit përbën një të drejtë të ofruar në mënyrë të njëjlojtë për të gjithë banorët e botës; pjesëmarrja gjithnjë e më e gjerë në turizmin vendës dhe ndërkombëtar duhet të konsiderohet si një nga



shprehjet më të mira të mundshme të rritjes së qëndrueshme të kohës së lirë dhe në këtë rrugë nuk duhet të vendosen pengesa.

2. E drejta për turizëm është rezultat i së drejtës për pushim dhe kohë të lirë, duke përfshirë kufizimin e arsyeshëm të orëve të punës dhe pushimeve periodike të paguara, në pajtim me traktatet ndërkombëtare.

3. Turizmi social dhe në veçanti turizmi shoqëruar, i cili lehtëson aksesin e gjerë në kohën e lirë, udhëtime dhe pushime, duhet të zhvillohet me mbështetjen e autoriteteve publike.

4. Turizmi familjar, rinor, studentor dhe për të moshuarit dhe turizmi për personat me aftësi të kufizuara duhet të inkurajohet dhe lehtësohet.

Neni 11

Liria e lëvizjes së turistëve

1. Turistët duhet të përfitojnë, në pajtim me të drejtën ndërkombëtare dhe legjislacionin e brendshëm, nga liria për të lëvizur brenda vendeve të tyre dhe nga një shtet në tjetrin, në pajtim me nenin 13 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut; ata duhet të kenë akses në vendet e tranzitit dhe të qëndrimit dhe në vendet turistike dhe kulturore pa iu nënshtuar formaliteteve të tepërta ose diskriminimit.

2. Turistët duhet të kenë akses në të gjitha format e disponueshme të komunikimit, të brendshëm ose të jashtëm; në rast nevojë, ata duhet të përfitojnë nga qasja e shpejtë dhe e lehtë në shërbimet lokale administrative, ligjore dhe shëndetësore; ata duhet të jenë të lirë të kontaktojnë përfaqësuesit e tyre konsullorë në pajtim me traktatet ndërkombëtare në fuqi.

3. Turistët duhet të përfitojnë nga të njëjtat të drejta, si qytetarët e vendit të vizituar në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale dhe informacionit që ata ofrojnë, veçanërisht kur ato ruhen në mënyrë elektronike.

4. Procedurat administrative, në lidhje me kalimet kufitare, qofshin ato brenda kompetencave të shteteve apo që rezultojnë nga marrëveshje ndërkombëtare, të tilla si vizat ose formalitetet shëndetësore dhe doganore, duhet të përshtaten, aq sa është e mundur, në mënyrë që të lehtësojnë maksimumin e lirisë së udhëtimit dhe qasjen e gjerë në turizmin ndërkombëtar; duhet të inkurajohet marrëveshjet ndërmjet grupeve të vendeve për të

harmonizuar dhe për të thjeshtuar këto procedura; taksat dhe detyrimet specifike që penalizojnë sektorin e turizmit dhe dëmtojnë konkurrencën e tij duhet të hiqen gradualisht ose të korrigjohen.

5. Për sa lejon situata ekonomike e vendeve nga vijnë turistët, këta duhet të kenë akses në monedhat e konvertueshme të nevojshme për udhëtimet e tyre.

Neni 12

Të drejtat e të punësuarve dhe profesionistëve në sektorin e turizmit

1. Të drejtat themelore të të punësuarve dhe profesionistëve në sektorin e turizmit dhe aktivitetet e lidhura duhet të garantohen nën mbikëqyrjen e administratave të brendshme dhe lokale, si të shteteve të tyre të origjinës ashtu dhe të vendeve pritëse me kujdes të veçantë, duke pasur parasysh kufizimet specifike që lidhen veçanërisht me sezonalitetin e veprimtarisë së tyre, dimensionin global të industrive të tyre dhe fleksibilitetin që shpesh u kërkohet atyre nga natyra e punës së tyre.

2. Të punësuarit dhe të vetëpunësuarit në sektorin e turizmit dhe aktivitetet e lidhura me to duhet të jenë në gjendje të kenë qasje në trajnimin e duhur fillestar dhe të vazhdueshëm; atyre u duhet dhënë mbrojtja e duhur shoqërore; pasiguria në punë duhet të jetë e kufizuar aq sa është e mundur; dhe punëtorëve sezonalë në sektor duhet t'u ofrohet një status specifik, veçanërisht në lidhje me mirëqenien e tyre sociale.

3. Çdo person fizik ose juridik, me kusht që ai ose ajo të ketë aftësitë dhe shprehitë e nevojshme, duhet të ketë të drejtë të zhvillojë një aktivitet profesional në fushën e turizmit, sipas ligjeve ekzistuese të brendshme, sipërmarrësit dhe investitorët – veçanërisht në fushën e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme – duhet të kenë të drejtën e hyrjes së lirë në sektorin e turizmit me një minimum kufizimesh ligjore ose administrative.

4. Shkëmbimet e përvojave të ofruara për drejtuesit dhe punëtorët nga vende të ndryshme kontribuojnë në nxitjen e zhvillimit të sektorit botëror të turizmit; këto lëvizje duhet të lehtësohen aq sa është e mundur në pajtim me ligjet e zbatueshme të brendshme dhe konventat ndërkombëtare.

5. Si një faktor i pazëvendësueshëm i solidaritetit në zhvillimin dhe rritjen dinamike të shkëmbimeve ndërkombëtare, ndërmarrjet



shumëkombëshe të sektorit të turizmit nuk duhet të shfrytëzojnë pozicionet dominuese që ndonjëherë zënë; ato duhet të shmangin shndërrimin në mjete të modeleve kulturore dhe sociale të imponuara artificialisht në komunitetet pritëse; në këmbim të lirisë së tyre për të investuar dhe për të tregtuar që duhet të njihet plotësisht, ato duhet të promovojnë modelet e konsumit dhe prodhimit vendës dhe të qëndrueshëm dhe të përfshihen në zhvillimin lokal, duke shmangur pakësimin e kontributit të tyre në ekonominë në të cilat ato janë themeluar nëpërmjet riatdhesimit të tepërt të fitimeve të tyre ose importeve të tyre përkatëse.

6. Partneriteti dhe vendosja e marrëdhënieve të ekuilibruara ndërmjet ndërmarrjeve të vendeve gjeneruese dhe pritëse kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit dhe në një shpërndarje të drejtë të përfitimeve të rritjes së tij.

KOMITETI BOTËROR PËR ETIKËN NË TURIZËM

Neni 13 Mandati

1. Komiteti Botëror për Etikën e Turizmit është një organ ndihmës i Asamblesë së Përgjithshme të OBTKB-së dhe, pavarësisht nga funksionet e kryera në lidhje me Kodin Global të Etikës për Turizmin, ai është përgjegjës për monitorimin e zbatimit të dispozitave të kësaj Konvente dhe kryerjen e çdo detyre tjetër që i është besuar nga Konferenca e Shteteve Palë.

2. Komiteti përcakton modalitetet për dorëzimin dhe shqyrtimin e raporteve të Shteteve Palë.

3. Komiteti miraton një raport dyvjeçar mbi zbatimin dhe interpretimin e Konventës që do të transmetohet nga Sekretari i Përgjithshëm i OBTKB-së në Asamblenë e Përgjithshme të OBTKB-së dhe në Konferencën e Shteteve Palë të kësaj Konvente.

4. Komiteti mund të veprojë, sipas rastit, edhe si një mekanizëm pajtimi për Shtetet Palë dhe aktorëve të tjerë në zhvillimin e turizmit në pajtim me Protokollin Opsional bashkangjitur Konventës Kuadër për Etikën në Turizëm.

Neni 14 Përbërja

1. Asambleja e Përgjithshme e OBTKB-së, në bashkëpunim me Konferencën e Shteteve Palë, përcakton përbërjen e Komitetit, si dhe modalitetet për caktimin dhe emërimin e anëtarëve të tij, me qëllim arritjen e pavarësisë dhe të paanësisë së tyre.

2. Asambleja e Përgjithshme e OBTKB-së, në bashkëpunim me Konferencën e Shteteve Palë, zgjedh anëtarët e Komitetit, duke i kushtuar vëmendjen e duhur baraspeshës gjinore dhe moshës dhe përfaqësimit të drejtë rajonal dhe sektorial.

Neni 15 Funksionimi

1. Sekretari i Përgjithshëm i OBTKB-së vendos në dispozicion të Komitetit personelin dhe burimet financiare të nevojshme për kryerjen e funksioneve të tij. Shpenzimet e nevojshme për funksionimin e Komitetit regjistrohen në buxhetin e Organizatës me Miratimin e Asamblesë së Përgjithshme.

2. Komiteti miraton rregullat e tij të procedurës brenda kornizës së kësaj Konvente. Teksti i rregullave të procedurës i transmetohet Konferencës së Shteteve Palë dhe Asamblesë së Përgjithshme të OBTKB-së për informacion.

KONFERENCA E SHTETEVE PALË

Neni 16 Përbërja dhe përgjegjësitë

1. Konferenca e Shteteve Palë është forumi plenar i kësaj Konvente të përbërë nga përfaqësues të të gjitha Shteteve Palë.

2. Konferenca e Shteteve Palë mbledhet në sesione të zakonshme çdo dy vjet së bashku me Asamblenë e Përgjithshme të OBTKB-së. Ajo mund të mbledhet në seancë të jashtëzakonshme nëse vendos kështu ose nëse Sekretari i Përgjithshëm i OBTKB-së merr një kërkesë për këtë qëllim nga të paktën një e treta e Shteteve Palë.

3. Prania e shumicës së Shteteve Palë është e nevojshme për të formuar një kuorum në mbledhjet e Konferencës së Shteteve Palë.

4. Konferenca e Shteteve Palë miraton rregullat e veta të procedurës dhe ndryshimet e tyre.



5. Konferenca e Shteteve Palë kryen, ndër të tjera, funksionet e mëposhtme:

a) shqyrtimin dhe miratimin e ndryshimeve në këtë Konventë dhe në Protokollin Opsional të Konventës Kuadër për Etikën në Turizëm, sipas rastit;

b) miratimin e planeve dhe programeve për zbatimin e kësaj Konvente; dhe marrjen e masave të tjera që mund t'i konsiderojë të nevojshme për të çuar përpara objektivat e kësaj Konvente; dhe

c) miratimin e udhëzimeve operationale për zbatimin dhe vënien në jetë të dispozitave të Konventës të përgatitura me kërkesë të saj nga Komiteti Botëror i Etikës në Turizëm.

6. Në takimet e saj Konferenca e Shteteve Palë mund të ftojë vëzhgues. Pranimi dhe pjesëmarrja e vëzhguesve u nënshtrohet rregullave të procedurës së Konferencës së Shteteve Palë.

7. Konferenca e Shteteve Palë mund të krijojë një fond, sipas rastit, për të mbuluar çdo shpenzim për zbatimin e Konventës që nuk mbulohet nga OBTKB-j a dhe përcakton kontributin e dhënë nga secili prej Shteteve Palë në këtë Konventë.

Neni 17

Sekretariati

Sekretariati i OBTKB-së siguron mbështetje administrative për Konferencën e Shteteve Palë, sipas nevojës.

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 18

Nënshkrimi

Kjo Konventë është e hapur për nënshkrim nga të gjithë Shtetet Anëtare të OBTKB-së dhe të gjitha Shtetet Anëtare të Kombeve të Bashkuara në Selinë e OBTKB-së në Madrid nga 16 tetori 2019 deri në 15 tetor 2020.

Neni 19

Ratifikimi, pranimi, aprovimi ose aderimi

Kjo Konventë u nënshtrohet ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit nga shtetet. Instrumentet e ratifikimit, pranimit, miratimit dhe aderimit depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të OBTKB-së.

Neni 20

Hyrja në fuqi

1. Kjo Konventë hyn në fuqi në ditën e tridhjetë pas datës së depozitimit të instrumentit të dhjetë të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit.

2. Për secilin Shtet Palë që ratifikon, pranon, miraton ose aderon në Konventë pas depozitimit të instrumentit të dhjetë të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, Konventa hyn në fuqi në ditën e tridhjetë pas depozitimit nga ky Shtet Palë i instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit.

Neni 21

Ndryshimi i Konventës

1. Çdo Shtet Palë mund të propozojë ndryshime në këtë Konventë.

2. Teksti i çdo ndryshimi të propozuar u komunikohet nga Sekretari i Përgjithshëm i OBTKB-së të gjitha Shteteve Palë, të paktën nëntëdhjetë ditë para hapjes së sesionit të Konferencës së Shteteve Palë.

3. Ndryshimet miratohen me shumicën e votave të dy të tretave të Shteteve Palë të pranishme dhe që votojnë dhe transmetohen nga Sekretari i Përgjithshëm i OBTKB-së tek Shtetet Palë për ratifikim, pranim, miratim ose aderim.

4. Instrumentet e ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit të ndryshimeve depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të OBTKB-së.

5. Ndryshimet e miratuara, në pajtim me paragrafin 3, hyjnë në fuqi për ato Shtete Palë që kanë ratifikuar, pranuar, aprovuar ose aderuar në këto ndryshime në ditën e tridhjetë pas datës së marrjes nga Sekretari i Përgjithshëm i OBTKB-së të instrumenteve të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit të të paktën pesë Shteteve Palë në këtë Konventë. Pas kësaj, për çdo Shtet tjetër Palë ndryshimet hyjnë në fuqi në ditën e tridhjetë pas datës në të cilën ai Shtet Palë depoziton instrumentin e tij.

6. Pas hyrjes në fuqi të një ndryshimi në këtë Konventë, çdo Shtet Palë i ri i Konventës bëhet Shtet Palë i Konventës së ndryshuar.



Neni 22 Denoncimi

1. Kjo Konventë mbetet në fuqi për një kohë të pacaktuar, por çdo Shtet Palë mund ta denoncojë atë në çdo kohë me anë të njoftimit me shkrim. Instrumenti i denoncimit depozitohet te Sekretari i Përgjithshëm i OBTKB-së. Pas një viti nga data e depozitimit të instrumentit të denoncimit, Konventa nuk është më në fuqi për Shtetin Palë denoncues, por mbetet në fuqi për Shtetet e tjera Palë.

2. Denoncimi nuk ndikon në asnjë detyrim të mundshëm financiar të Shtetit Palë denoncues, asnjë kërkesë për informacion ose ndihmë të bërë apo procedurën për zgjidhjen paqësore të mosmarrëveshjeve të filluara gjatë kohës që Konventa ka qenë në fuqi për Shtetin Palë denoncues.

Neni 23 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë ndërmjet Shteteve Palë, në lidhje me zbatimin ose interpretimin e kësaj Konvente zgjidhet përmes kanaleve diplomatike ose, në rast mospasë, me çdo mënyrë tjetër të zgjidhjes paqësore të vendosur nga Shtetet Palë të përfshira, përfshirë, sipas rastit, mekanizmin e pajtimit të parashikuar në Protokollin Opsional.

Neni 24 Tekstet autentike

Tekstet në gjuhën arabe, angleze, franceze, ruse dhe spanjolle të kësaj Konvente konsiderohen njësoj autentike.

Neni 25 Depozituesi

1. Sekretari i Përgjithshëm i OBTKB-së është depozituesi i kësaj Konvente.

2. Sekretari i Përgjithshëm i OBTKB-së u transmeton kopje të vërtetuara secilit prej Shteteve Palë nënshkruese.

3. Sekretari i Përgjithshëm i OBTKB-së njofton Shtetet Palë për nënshkrimet, për depozitimet e instrumenteve të ratifikimit, pranimit, miratimit dhe aderimit, ndryshimeve dhe denoncimit.

Neni 26 Regjistrimi

Në pajtim me nenin 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara, kjo Konventë regjistrohet te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara nga Sekretari i Përgjithshëm i OBTKB-së.

PROTOKOLLI OPSIONAL I KONVENTËS KUADËR PËR ETIKËN NË TURIZËM

Palët e Larta Kontraktuese,

duke caktuar Konventën Kuadër për Etikën në Turizëm (më poshtë referuar si “Konventa”) si një kornizë themelore referimi për zhvillimin e turizmit të përgjegjshëm, të qëndrueshëm dhe botërisht të arritshëm;

duke njohur që mosmarrëveshjet në sektorin e turizmit ndonjëherë mund të dëmtojnë seriozisht ndikimet pozitive të sektorit drejt një zhvillimi harmonik social-kulturor dhe ekonomik, dhe përparimit të paqes dhe të prosperitetit;

me qëllim plotësimin e kësaj Konvente Kuadër me një Protokoll Opsional, i cili është një instrument ligjor i veçantë dhe i pavarur i hapur për Shtetet Palë në këtë Konventë, duke parashikuar një proces për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, që mund të orientojë dhe të forcojë zbatimin e parimeve etike nga të gjitha palët e interesuara;

duke inkurajuar të gjitha palët që të përipiqen të zgjidhin të gjitha mosmarrëveshjet në mënyrë paqësore, para se t’i drejtohen procesit gjyqësor, kanë rënë dakord si më poshtë:

1. Komiteti Botëror i Etikës në Turizëm (më poshtë i referuar si “Komiteti”) vepron si një mekanizëm i pavarur dhe vullnetar pajtimi, për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë ndërmjet Shteteve Palë të këtij Protokollit ose palëve të interesit në zhvillimin e turizmit, në lidhje me interpretimin ose zbatimin e Konventës.

2. Çdo mosmarrëveshje ndërmjet dy ose disa Shteteve Palë të këtij Protokollit, ose një Shteti Palë dhe një ose më shumë palëve të interesit mund t’i referohen Komitetit.

3. Për sa kohë që Palët bien dakord të paraqesin mosmarrëveshjen në Komitet, ato duhet të paraqesin deklaratat me shkrim, të shoqëruara me të gjitha dokumentet dhe provat e tjera që konsiderohen të nevojshme te kryetari i Komitetit, i



cili cakton një nënkomitet prej tre anëtarësh përgjegjës për shqyrtimin e mosmarrëveshjes dhe për formulimin e rekomandimeve të përshtatshme për të formuar bazën e një zgjidhjeje.

4. Në mënyrë që të miratojë rekomandimet përkatëse, nënkomiteti mund t'u kërkojë Palëve informacion shtesë dhe, nëse konsiderohet i dobishëm, mund t'i dëgjojë ato me kërkesën e tyre; shpenzimet e nevojshme të shkaktuara nga procedura e pajtimit mbulohen nga Palët në mosmarrëveshje. Mosparaqitja e njëjës prej Palëve edhe pse i është dhënë një mundësi e arsyeshme për të marrë pjesë nuk pengon që nënkomiteti të miratojë rekomandimet e tij.

5. Në qoftë se nuk është rënë dakord ndryshe nga Palët në mosmarrëveshje, Komiteti shpall rekomandimet e nënkomitetit brenda tre muajve nga data në të cilën iu referua mosmarrëveshja. Palët në mosmarrëveshje informojnë kryetarin e Komitetit për çdo zgjidhje të arritur në bazë të rekomandimeve dhe për çdo veprim të ndërmarrë për të zbatuar një zgjidhje të tillë.

6. Nëse brenda një periudhe prej dy muajsh pas njoftimit të rekomandimeve, Palët në mosmarrëveshje nuk kanë arritur të bien dakord mbi kushtet e një zgjidhjeje përfundimtare, Palët mund ta referojnë, veçmas ose bashkërisht, mosmarrëveshjen në një seancë plenare të Komitetit.

7. Seanca plenare e Komitetit miraton një vendim që do t'u njoftohet Palëve në mosmarrëveshje dhe, nëse Palët në mosmarrëveshje bien dakord, bëhet publik. Nëse Palët në mosmarrëveshje bien dakord me vendimin, atyre u kërkohet ta zbatojnë atë në rastin më të shpejtë të mundshëm dhe ato i japin informacion në kohën e duhur kryetarit të Komitetit mbi veprimet që ato kanë ndërmarrë për të zbatuar vendimin e sipërpërmendur.

8. Një Shtet Palë, në momentin e ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, ose në një datë tjetër të mëvonshme, mund të deklarojë se bie dakord në lidhje me çdo Shtet tjetër Palë, duke marrë përsipër të njëjtin detyrim dhe ta konsiderojë të detyrueshëm vendimin e Komitetit në çdo mosmarrëveshje të mbuluar nga ky Protokoll, mbi të cilin nuk është arritur asnjë zgjidhje në pajtim me paragrafin 4.

9. Strukturat e turizmit dhe ndërmarrjet e turizmit, si dhe shoqatat e tyre, mund të përfshijnë në dokumentet e tyre kontraktuale një dispozitë që

i bën të detyrueshme vendimet e Komitetit në marrëdhëniet e tyre me palët e tyre kontraktuese.

10. Me përjashtim të rasteve kur paraqiten elemente të reja, Komiteti nuk merr në konsideratë çështjet të cilat i ka trajtuar tashmë (*non bis in idem*) dhe informon Palët në mosmarrëveshje në përputhje me rrethanat.

11. Ky Protokoll është i hapur për ratifikim, pranim, miratim ose aderim nga Shtetet Palë në Konventë. Rregullat në lidhje me ndryshimin dhe denoncimin e Konventës zbatohen *mutatis mutandis* edhe për Protokollin. Protokollin përbën një shtojcë të Konventës për Shtetet që kanë ratifikuar, pranuar, miratuar ose aderuar në të.

12. Denoncimi i Konventës përfshin denoncimin e menjëhershëm të këtij Protokoll. Denoncimi hyn në fuqi një vit pas marrjes së instrumentit të denoncimit. Sidoqoftë, Shtetet Palë që denoncojnë Protokollin mbeten të detyruara nga dispozitat e tij, në lidhje me çdo mosmarrëveshje që mund t'i jetë referuar Komitetit përpara fundit të periudhës njëvjeçare të parashikuar më sipër.

13. Protokollin hyn në fuqi në ditën e tridhjetë pas datës së depozitimit të instrumentit të dytë të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit.

14. Për secilin Shtet Palë, që ratifikon, pranon, miraton ose aderon në Protokoll pas depozitimit të instrumentit të dytë të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, Protokollin hyn në fuqi në ditën e tridhjetë pas depozitimit nga ky Shtet Palë i instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit.

DEKRET

Nr. 13495, datë 25.2.2022

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 18/2022, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Kuadër për Etikën në Turizëm dhe protokollin opsional të saj”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË

Ilir Meta



VENDIM
Nr. 2, datë 23.2.2022

**PËR DISA SHITESA E NDRYSHIME NË
VENDIMIN NR. 4, DATË 11.3.2019, TË
KËSHILLIT TË EMËRIMEVE NË
DREJTËSI, “PËR PROCEDURËN E
VERIFIKIMIT TË KANDIDATËVE, PËR
POZICIONET VAKANTE NË GJYKATËN
KUSHTETUESE DHE TË INSPEKTORIT
TË LARTË TË DREJTËSISË”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 229, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

VENDOSI:

Në vendimin nr. 4, datë 11.3.2019, të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, bëhen këto shtesa e ndryshime:

1. Në fund të fjalisë së parë të pikës 15, mbas fjalëve “për efekt të komunikimit dhe njoftimeve me Këshillin” shtohen fjalët “së bashku me të dhënat personale të nevojshme për krijimin e llogarisë fillestare në sistemin EACIDS (*email primar, numër telefoni dhe NID*)”.

2. Në pikën 20, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Germa “a” ndryshon me përmbajtjen si vijon:

“a) mbledhjen e të dhënave personale të kandidatit të nevojshme për krijimin e llogarisë fillestare në sistemin EACIDS”;

b) Pas germës “e”, shtohet germa “ë” me përmbajtjen si vijon:

“ë) pajisjen e kandidatit me formularin e vetëdeklarimit për pozicione drejtuese të mbajtura në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit, sipas modelit të përcaktuar në lidhjen nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.”.

3. Pika 58 ndryshon me përmbajtjen si vijon:

“58. Jo më vonë se 3 ditë nga dita e njoftimit zyrtar për fillimin e procedurës së verifikimit, kandidati paraqitet në zyrën e posaçme të Këshillit, pranë Gjykatës së Lartë, për të dorëzuar autorizimet, si dhe të dhënat personale të

nevojshme për krijimin e llogarisë në sistemin EACIDS nga ana e IDKPKI-së.

Për mënyrën dhe procedurën e plotësimit të deklaratës së pasurive dhe interesave privatë, kandidati duhet të zbatojë aktet e miratuara nga Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së për këtë qëllim.”.

4. Në pikën 60 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) fjalía e parë ndryshon me përmbajtjen si vijon:

“Jo më vonë se 5 ditë nga dita e depozitimit në Këshill të autorizimeve, të nënshkuara rregullisht nga kandidati dhe personat e lidhur.”;

b) në germën “a”, mbas fjalëve “sipas ligjit nr. 115/2016” shtohen fjalët “, së bashku me të dhënat e tyre personale, të nevojshme për krijimin e llogarisë në sistemin EACIDS”.

5. Pika 61 ndryshon me përmbajtjen si vijon:

“Jo më vonë se 15 ditë nga dita e krijimit të llogarisë nga ana e ILDKPKI-së, kandidati e dorëzon formularin e plotësuar të deklaramit të pasurisë:

a) në formë elektronike, duke kryer plotësimin dhe aprovimin e versionit përfundimtar të deklaratës në sistemin EACIDS; dhe

b) në formë shkresore, duke printuar dhe nënshkuar në çdo fletë deklaratën e pasurisë, të plotësuar në formë elektronike, e cila dorëzohet e mbyllur në zarf pranë ILDKPKI-së”.

6. Në pikën 78, germa “a” ndryshon me përmbajtjen si vijon:

“a) ka refuzuar të dorëzojë të dhënat personale të nevojshme për krijimin e llogarisë fillestare në sistemin EACIDS ose nuk i ka plotësuar dhe depozituar formularët pranë ILDKPKI-së brenda afatit.”.

7. Në kreun V “Dispozita kalimtare dhe të fundit”, mbas germës “Ç”, shtohet germa “Ç/1” me përmbajtjen si vijon:

“Ç/1. Rregulla kalimtare për dorëzimin e formularëve të deklaramit të pasurisë nga kandidatët në formë shkresore

114/1. Për pozicionet vakante të krijuara në Gjykatën Kushtetuese dhe të shpallura për aplikim nga organet e emërtesës para hyrjes në fuqi të këtij vendimi, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në këtë vendim, si dhe aktet nënligjore të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, lidhur me procedurat e deklaramit të pasurisë.



Brenda 3 ditësh nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, kandidatët për të cilët nuk është hapur llogari fillestare pranë ILDKPKI-së duhet të njoftohen për t'u paraqitur dhe për të dorëzuar në Këshill të dhënat personale të nevojshme për krijimin e llogarisë në sistemin EACIDS nga ana e ILDKPKI-së. Në këtë rast, afatet fillojnë të ecin sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Kryetar: Sokol Binaj

Anëtarë: Marsida Xhaferllari (zëvendës-kryetare), Elsa Toska, Edlira Petri, Enton Dhimitri, Anila Leka, Genti Xholi, Etien Kapo, Klodiana Mema (Veizi)

Lidhja nr. 1

**FORMULAR VETËDEKLARIMI
PËR POZICIONET DREJTUESE TË MBAJTURA NË PARTI POLITIKE NGA
KANDIDATI GJATË 10 VITEVE TË FUNDIT NGA DATA E KANDIDIMIT**

(Plotësohet nga kandidati që konkurren për *anëtar të Gjykatës Kushtetuese/Inspektor i Lartë i Drejtësisë*)

**I. Të dhënat e kandidatit
Gjeneralitetet**

Emri	
Atësia	
Mbiemri	
Datëlindja	
Numri ID	

II. A keni mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit? (Vendosni shenjën X përmbri përgjigjes)

PO / JO

(Nëse përgjigjeni PO, tregoni pozicionin drejtues që keni mbajtur, si dhe datën në të cilën keni ndërprerë ushtrimin e pozicionit drejtues):

(Shënim. Për qëllime të ligjit, “*pozicion drejtues në parti*” konsiderohen strukturat hierarkike më të larta, monokratike apo kolegjiale, me natyrë vendimmarrëse dhe udhëheqëse në drejtim të hartimit, miratimit



dhe zbatimit të qëllimeve dhe objektivave politikë të partisë përkatëse, ku përfshihen, por pa u kufizuar, rastet si vijon:

- a) kryetar/ kryetar nderi i Partisë;
- b) sekretar i përgjithshëm i partisë;
- c) anëtar i kryesisë së partisë apo i një strukture ekuivalente;

(emër, mbiemër, nënshkrimi)

- d) anëtar i këshillit drejtues apo strukture ekuivalente;
- e) sekretar për një fushë të caktuar;
- f) kryetar i një dege të partisë në rreth;
- g) sekretar i një dege të partisë në rreth;
- h) çdo funksionar tjetër i cili kryen një detyrë apo mban një post që konsiderohet pozicion drejtues sipas statutit të partisë.

Unë, i/e nënshkruari/a _____, me nënshkrimin e këtij formulari konfirmoj, nën përgjegjësinë time ligjore, saktësinë e të dhënave të pasqyruara këtu dhe jam i vetëdijshëm se pasqyrimi i të dhënave të pavërteta, të paplota dhe të pasakta në këtë formular mund të passjellë si pasojë skualifikimin e menjëhershëm, dhe në çdo kohë nga kandidimi/zgjedhja/emërimi apo ushtrimi i mëtejshëm i funksionit publik.

Datë ___/___/_____

(emër, mbiemër, nënshkrimi)

VENDIM
Nr. 32, datë 24.2.2022

**PËR MIRATIMIN E “STANDARDEVE
TË ETIKËS DHE RREGULLAVE TË
SJELLJES SË PROKURORIT”**

Bazuar në nenin 149/“a”, pika 1, germa “ç”, të Kushtetutës; në nenet 164, pika 8, 182, pika 1, 189, pika 1, germa “b”, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar; dhe në nenin 4, pika 3, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e grupit të punës ngritur me urdhrin e kryetarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nr. 1297 prot., datë 16.6.2021, Këshilli i Lartë i Prokurorisë

VENDOSI:

1. Miratimin e “Standardeve të etikës dhe rregullave të sjelljes së prokurorit”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

ZËVENDËSKRYETAR
Alfred Balla

**STANDARDET E ETIKËS DHE
RREGULLAT E SJELLJES SË PROKURORIT**

HYRJE

Standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes së Prokurorit synojnë të vendosin, ruajnë dhe forcojnë integritetin profesional dhe personal të prokurorëve, si dhe të rrisin efektivitetin, paanshmërinë dhe përgjegjshmërinë gjatë dhe jashtë ushtrimit të funksioneve të tyre, në emër dhe në interes të shoqërisë, si pjesë e sistemit të drejtësisë penale. Këto rregulla përkrahin zbatimin e standardeve më të larta të sjelljes etike dhe profesionale, ruajtjen e imazhit të profesionistit, si dhe sjelljen e përshtatshme në zyrë, në prokurori, në gjykatë apo jashtë këtyre ambienteve, për shkak



të funksionit si prokuror. Ato plotësojnë kuadrin e akteve normative në fuqi të nxjerra për prokurorët.

Duke pasur parasysh standardet e njohura në instrumentet ndërkombëtare, që mbrojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të cilat në mënyrë të veçantë i garantojnë çdo shtetasi barazinë para ligjit, prezumimin e pafajësisë dhe të drejtën për gjykim të drejtë dhe publik brenda një kohe të arsyeshme nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e themeluar me ligj;

Duke respektuar udhëzimet mbi rolin e Prokurorëve, të miratuara nga Kongresi i Tetë i Kombeve të Bashkuara mbi Parandalimin e Krimit dhe Trajtimin e Shkelësve të ligjit (27 gusht–7 shtator 1990);

Në përputhje me sa parashikohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; në ligjin nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar; në ligjin nr. 95/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, i ndryshuar; në ligjin nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar; si dhe në legjislacionin në fuqi;

Duke iu referuar rekomandimit (2000) 19, “Mbi rolin e prokurorit publik në sistemin e drejtësisë penale”; rekomandimit (2012) 11, “Mbi rolin e prokurorit publik jashtë sistemit të drejtësisë penale”, të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës; raportit “Mbi standardet evropiane lidhur me pavarësinë e sistemit gjyqësor: Pjesa e II – Shërbimi i Prokurorisë”, të adaptuara më datë 17–18 dhjetor 2010 nga Komisioni i Venecias, dhe duke i konfirmuar rregullat të cilat ato shprehin;

Duke mbajtur parasysh sa përmbajnë “Standardet e përgjegjësisë profesionale dhe gjendjen e të drejtave dhe detyrave thelbësore të prokurorëve”, të adaptuara nga Shoqata Ndërkombëtare e Prokurorëve më 23 prill 1999, “Parimet e Bangalorit mbi sjelljen gjyqësore”, të miratuara nga Grupi Gjyqësor për Forcimin e Integritetit Gjyqësor (2002), “Udhëzuesi Evropian

mbi Etikën dhe Sjelljen për prokurorët publikë” (Udhëzuesi i Budapestit), i miratuar nga Konferenca e Përgjithshme e Prokurorëve të Evropës (31 maj 2005), opinionin nr. 13 (2018), i Këshillit Konsultativ të Prokurorëve Evropianë “Pavarësia, përgjegjshmëria dhe etika e prokurorëve”; opinionin nr. 8 (2013), i Këshillit Konsultativ të Prokurorëve Evropianë mbi marrëdhëniet ndërmjet Prokurorëve dhe Medies; opinionin nr. 9 (2014) i Këshillit Konsultativ të Prokurorëve Evropianë mbi Normat dhe parimet Evropiane lidhur me prokurorët (Roma Charter); opinionin nr. 4 (2009) i Këshillit Konsultativ të Prokurorëve Evropianë mbi Marrëdhëniet ndërmjet Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në një shoqëri demokratike dhe Kodi Global i Etikës Gjyqësore të Bolonjës dhe të Milanos, miratuar në Konferencën Ndërkombëtare për Pavarësinë Gjyqësore (2015);

Të vetëdijshëm që integriteti dhe paanshmëria e sistemit të prokurorisë janë parakushte për mbrojtjen efektive të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, si dhe zhvillimin ekonomik;

Këshilli i Lartë i Prokurorisë përcakton standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes së prokurorit, si më poshtë.

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

1. Standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes së Prokurorit përbëhen nga tërësia e parimeve, normave dhe rregullave gjerësisht të pranueshme, të cilat udhëheqin sjelljen e prokurorit gjatë ushtrimit të detyrës, gjatë kryerjes së veprimtarisë jashtë funksionit, si dhe në jetën private.

2. Prokurori duhet të ruajë dhe të zbatojë standarde të larta të sjelljes etike dhe profesionale, si dhe duhet t'i respektojë personalisht këto standarde, në mënyrë që integriteti dhe pavarësia e tij të ruhen, si dhe të parandalohen shkeljet e ligjit. Këto rregulla duhet të interpretohen dhe të zbatohen për të arritur këtë objektiv.

3. Format specifike të sjelljes të parashikuara në këto rregulla sjelljeje nuk janë shteruese, pasi nuk ofrojnë një listë të plotë të të gjitha situatave me të cilat prokurori mund të përballlet në praktikë.



Neni 2
Fusha e veprimit

1. Standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes së Prokurorit zbatohen nga të gjithë prokurorët e sistemit të prokurorisë. Pjesë të këtyre rregullave të cilat kanë të bëjnë me veprimtarinë jashtë funksionit dhe jetën private zbatohen dhe nga prokurorët e komanduar në pozicione të tjera.

2. Këto rregulla zbatohen për aq sa është e mundur edhe për nëpunësit civilë në prokurori dhe këshilltarët ligjorë. Të gjitha subjektet ndaj të cilëve zbatohen këto rregulla duhet të marrin masa që të përshtatin menjëherë marrëdhëniet dhe veprimtarinë e tyre në pajtim me to.

KREU II
PARIMET BAZË DHE RREGULLAT E SJELLJES

Neni 3
Parimet bazë

Parimet mbi të cilat mbështeten standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes së prokurorit janë:

- a) pavarësia;
- b) paanshmëria;
- c) pastërtia e figurës;
- ç) sjellja e hijshme dhe me vetëpërmbajtje;
- d) kujdesi i duhur dhe profesionalizmi;
- dh) respekti dhe aftësia për të dëgjuar;
- e) trajtimi i barabartë;
- ë) transparenca.

Neni 4
Pavarësia

Prokurori përgjigjet vetëm përpara ligjit. Ai përmbush detyrat e tij i lirë nga çdo ndikim i jashtëm dhe është i pavarur nga pushtetet e tjera, nga grupet e interesit dhe nga palët në një proces penal. Prokurori nuk është i detyruar t'i sqarojë qëndrimet e tij ligjore dhe gjendjen e vërtetuar të fakteve, përveçse kur arsyet vendimmarrjen e tij ose kur kjo i kërkohet për shkak të ligjit. Sipas këtij parimi prokurori:

a) respekton dhe punon për një sistem prokurorie të pavarur, si në aspektin individual ashtu edhe në aspektin institucional;

b) kujdeset gjithmonë që sjellja e tij, zyrtare apo private, të mos cenojë pavarësinë individuale apo institucionale të prokurorisë.

c) Prokurori duhet të shmangë sjelljet që mund të krijojnë përshtypjen se është i angazhuar politikisht dhe as të marrë pjesë në aktivitete politike, në çfarëdolloj mënyre, me përjashtim të çështjeve me rëndësi për funksionimin e prokurorisë dhe pavarësinë e tyre;

ç) nuk duhet të japë kontribute financiare apo kontribute të tjera subjekteve politike dhe as të nënshkruajë peticione që ndërmerren nga subjekte politike;

d) kujdeset që të jetë i pavarur nga kolegët e tij. Ai mund të këshillohet me kolegët prokurorë, por përgjegjësia në vendimmarrje është vetëm e tij;

dh) duhet të mos ndikohet nga reagimi publik, që mund të shkaktojë veprimtaria e tij;

e) mund të refuzojë pjesëmarrjen në një procedim penal, ku mund të vihet në diskutim pavarësia e tij, pavarësisht nëse kjo kërkohet apo jo nga palët.

Neni 5
Paanshmëria

Në kryerjen e detyrave procedurale, prokurori është i paanshëm dhe duhet të duket i tillë. Prokurori vepron me paanësi, i lirë nga çdo lidhje, prirje ose paragjykim që ndikon ose mund të duket se ndikon, në aftësinë e tij për të vepruar në mënyrë të paanshme. Në këtë kuptim, paanësia duhet të jetë e dukshme gjatë ushtrimit të funksioneve të prokurorit. Sipas këtij parimi prokurori:

a) merr masa që sjellja e tij në prokurori, në gjykatë dhe jashtë tyre të garantojë dhe rrisë besimin e publikut, praktikuesve të tjerë të ligjit dhe të palëve të vetë prokurori dhe sistemi i drejtësisë;

b) shmang çdo lloj sjelljeje që mund të krijojë përshtypjen e anshmërisë;

c) nuk duhet të ndikohet nga presioni, frika, mendimi personal apo paragjykimi, nga ide paraprake mbi çështjen që ka për ndjekje dhe as të mbështesë në mënyrë të papërshtatshme interesat e një pale, në dëm të palës tjetër;

ç) shmang situatat, që në mënyrë të arsyeshme mund të perceptohen se çojnë drejt një konflikti interesi;

d) mund të mos marrë pjesë në ndjekjen e një çështjeje, nëse ai çmon se nuk është në gjendje të



veprojë në mënyrë të paanshme ose një vëzhguesi të arsyeshëm mund t'i krijohet përshtypja që prokurori nuk është në gjendje të veprojë mbi çështjen në mënyrë të paanshme;

dh) brenda kufijve të arsyeshëm, vepron në mënyrë të tillë që të minimizohen rastet ku do të jetë i nevojshëm përjashtimi i tij nga ndjekja e çështjes;

e) përveç rasteve të parashikuara me ligj, prokurori nuk duhet të iniciojë apo të konsiderojë komunikimin jashtë procesit penal me palët;

ë) duhet të tregojë vetëpërmbytje në mbështetjen publikisht apo shprehjen e kritikave të çfarëdo lloji dhe natyre ndaj pushteteve të tjera, përveç çështjeve që lidhen funksionimin e sistemit të drejtësisë;

f) duhet të shmanget nga bërja e komenteve mbi çështje të diskutueshme politike apo deklarata publike, të cilat mund të krijojnë përshtypjen se prokurori është i njëanshëm ose i ndikuar në një çështje të caktuar;

g) duhet të jetë i kujdesshëm në marrëdhëniet që krijon, për shkak të anëtarësisë së tij në shoqatat e prokurorëve apo në shoqata kulturore, sportive, fetare ose të fushave të tjera, duke shmangur ato marrëdhënie që mund të ndikojnë në paanshmërinë e tij, si dhe që cenojnë imazhin e tij ose të sistemit të prokurorisë;

h) nuk duhet të pranojë favore apo përfitime, për veten apo të afërmit e tij, të tilla që mund të venë në diskutim paanshmërinë e tij;

i) shmang çdo situatë që në fakt apo në dukje, e lidh prokurorin me palët në proces.

Neni 6

Pastërtia e figurës

Prokurori sillet gjithmonë në mënyrë të tillë që të ruajë dinjitetin, përgjegjësitë në funksion dhe paanshmërinë e pavarësinë e prokurorisë. Sjellja dhe qëndrimi i prokurorit duhet të rikonfirmojë besimin e qytetarëve te sistemi i prokurorisë. Sipas këtij parimi, prokurori:

a) kujdeset për ruajtjen e pastërtisë së figurës, si gjatë ushtrimit të detyrës, ashtu dhe në jetën e tij private, me qëllim garantimin e besimit të publikut te sistemi i prokurorisë;

b) sigurohet që sjellja e tij të jetë dinjitoze në sytë e publikut;

c) nuk lejon që marrëdhëniet familjare, shoqërore apo të tjera të ndikojnë në mënyrë të papërshtatshme në sjelljen apo ushtrimin e detyrës së tij;

ç) duhet të udhëhiqet nga mirësjellja dhe ndershmëria profesionale, korrektesa në marrëdhëniet e tij me kolegët, administratën e prokurorisë, palët e tjera në proces apo përfaqësuesit e tyre, median dhe publikun;

d) shmang sjelljet që bien në kundërshtim me ligjin dhe bën përpjekje që të shmangë çdo sjellje që tregon mungesë ndjeshmërie apo kujdesi;

dh) shmang çdo përfitim personal për vete, familjarë apo të tjerë, që i vijnë për shkak të detyrës si prokuror dhe nuk lejon me vetëdije që të tjerët të japin përshtypjen se kanë një pozicion të veçantë për të pasur ndikim të papërshtatshëm në ushtrimin e detyrës së prokurorit;

e) nuk kërkon dhe as pranon dhurata, hua apo favore për vete ose anëtarët e familjes së tij, që i vijnë për shkak të ushtrimit të detyrës;

ë) nuk lejon me vetëdije anëtarët e familjes, personelin e prokurorisë apo të tjerë, të kërkojnë ose të pranojnë dhurata, hua apo favore, që iu bëhen për shkak të ushtrimit të detyrës së prokurorit;

f) mund të marrë dhurata simbolike, çmime ose përfitime, sipas rastit për të cilin jepet dhe në përputhje me ligjin, me kusht që dhurata, çmimi apo përfitimi, të mos perceptohen nga publiku, si shkak njëanshmërie apo si qëllim për të ndikuar te prokurori në ushtrimin e detyrës;

g) mund të pranojë dekorime dhe tituj nderi, vetëm kur pranimi i tyre nuk ngre dyshime të arsyeshme për njëanshmëri ose cenim të pavarësisë së prokurorit.

Neni 7

Sjellja e hijshme dhe me vetëpërmbytje

Prokurori shmang sjelljen e pahijshme dhe shfaqjen e saj në të gjitha aktivitetet e tij. Si subjekt i vëzhgimit të vazhdueshëm publik, prokurori duhet të pranojë kufizime personale që mund të shihen si të paarsyeshme për një qytetar të thjeshtë dhe këtë duhet ta bëjë lirshëm dhe me dëshirë. Prokurori shmang çdo sjellje, e cila krijon dyshimin e arsyeshëm se vendimet e tij nxiten nga motive të tjera, përtej zbatimit të drejtë të ligjit. Prokurori sillet me vetëpërmbytje me synim arritjen e një



balance mes të drejtave të tij si qytetar dhe kufizimeve, që lidhen me funksionin e tij. Sipas këtij parimi, prokurori:

a) përpiket në maksimum që sjellja e tij të mos cenojë besimin që publiku ka tek ai në ushtrimin e detyrës dhe në jetën e tij private;

b) duhet të respektojë dinjitetin e funksionit. Si çdo qytetar tjetër, ai gëzon lirinë e shprehjes, besimit, tubimit dhe organizimit, pjesëmarrja në të cilat nuk ndalohet në mënyrë të shprehur, por në ushtrimin e këtyre të drejtave, ai duhet të ruajë dinjitetin e funksionit, paanshmërinë dhe pavarësinë e prokurorit. Prokurori duhet të marrë në konsideratë rrezikun e shprehjes së pikëpamjeve që mund të sjellin paragjykitime në çështje që mund të përfaqësojnë më vonë. Ai tregon po të njëjtin kujdes kur përballlet me kritika apo sulme;

c) nuk lejon që zyra e tij të përdoret për qëllime të tjera të ndryshme nga ato që lidhen me ushtrimin e veprimtarisë së prokurorisë;

ç) mban veshur togën e prokurorit gjatë ushtrimit të funksionit në salla gjykimi apo në hapësira të tjera që i zëvendësojnë ato, ndërsa në raste të tjera, gjatë kohës së punës ose kur vepron si përfaqësues i prokurorisë, u përmbahet rregullave të veshjes formale të përshtatshme, sipas rrethanave;

d) duhet t'i kërkojë personelit administrativ të prokurorisë që mbështet veprimtarinë e tij, të zbatojë për aq sa është e mundur, këto rregulla sjelljeje gjatë kryerjes së detyrave të tyre. Një prokuror nuk duhet të orientojë personelin e prokurorisë që të angazhohet për të kryer veprime në emër të prokurorit ose si përfaqësues i tij, kur këto veprime do të binin ndesh me këto rregulla nëse do të kryheshin nga vetë prokurori;

dh) nuk duhet të përdorë informacionin konfidencial për të cilin prokurori vihet në dijeni për shkak të detyrës apo ta zbulojë atë për ndonjë qëllim tjetër që nuk lidhet me ushtrimin e detyrës;

e) nuk duhet të nxisë krijimin, pjesëmarrjen, ose të anëtarësohet në ndonjë organizatë që mbështet çfarëdolloj diskriminimi, që nuk ka transparencë të anëtarësisë apo që mban qëndrim denigrues ndaj sistemit të drejtësisë ose parimeve të shtetit demokratik dhe të së drejtës. Prokurori duhet të ketë kujdes që të mos bëhet shkak që publiku ta lidhë me një organizatë, grup apo kauzë të veçantë. Pjesëmarrja e prokurorit nuk duhet të jetë në rrethana që mund të sjellin perceptimin e

njëanshmërisë me një organizim (përfshirë një dhomë apo zyrë avokatie), grup apo kauzë të caktuar;

ë) nuk duhet të përfshihet në veprimtari apo organizata që shfrytëzojnë anëtarësinë e prokurorit për çdo lloj përfitimi;

f) duhet të shmangë shfaqjen e bindjeve të tij politike edhe pse ai si çdo qytetar, gëzon të drejtën për të pasur të tilla;

g) duhet të shfaqë vetëpërmbytje edhe në marrëdhëniet e tij me medien. Për çështje që lidhen me marrëdhëniet me medien, prokurori komunikon me prokurorin e medias të juridiksionit përkatës, duke shmangur çdo shfrytëzim të njohjeve personale me gazetarët;

h) nuk duhet të shprehë mosdakordësinë e tij mbi një vendim gjyqësor në shtyp. Ai nuk i komenton publikisht qëndrimet e tij në lidhje me çështjen, edhe nëse ato kritikohen nga media apo të tjerë ose nuk pranohen nga gjykata. Prokurori duhet të përmbahet nga përgjigjet ndaj kritikës publike ndaj një vendimi apo qëndrimi, goftë në sallë apo jashtë saj. Ai duhet të jetë i kujdesshëm kur ai keqinterpretohet ose është i vetëdijshëm që diçka e tillë mund të ndodhë, veçanërisht kur përfaqëson një çështje penale me ndjeshmëri publike. Prokurori e shpreh mendimin e tij në lidhje me një çështje vetëm në arsyetimin e akteve procedurale që ai harton;

i) nuk duhet të publikojë pa miratim paraprak, në asnjë formë, si kontribut personal apo akademik, akte procedurale që ai harton si prokuror i vetëm apo si pjesë e një grupi prokurorësh, me përjashtim të rastit kur pjesë të vendimit citohen për qëllime me natyrë akademike;

j) mund të marrë pjesë në aktivitete që lidhen me sistemin e drejtësisë dhe mund të bëjë vetëm deklarata të përgjithshme, në kuadër të pjesëmarrjes në këto aktivitete. Prokurori mund të marrë pjesë edhe në aktivitete që nxitin vlerat qytetare, edukuese, fetare, bamirësie, si dhe mund të bëjë deklarata përgjithshme vetëm në kuadër të pjesëmarrjes në këto aktivitete, pa cenuar pavarësinë dhe paanshmërinë e sistemit të drejtësisë;

k) nuk duhet të përdorë statusin e tij si prokuror në jetën e tij private. Ai nuk duhet të krijojë përshtypje që do të ushtrorë pushtet mbi palët e treta, apo t'i bëjë ata që të mendojnë se prokurori, edhe në nivel personal dhe privat, ka të drejtë të



ushtrojë pushtetet që ia atribuon ligji gjatë veprimtarisë së tij;

l) nuk duhet të frekuentojnë ambiente apo lokale, të cilat dëmtojnë imazhin e tij si prokuror;

m) nuk konsumon pije alkoolike gjatë ushtrimit të funksionit, ndërsa jashtë ushtrimit të funksionit nuk konsumon pije alkoolike në atë masë që mund ndikojë sjelljen e tij dhe që bien ndesh me dinjitetin e funksionit e prokurorit.

Neni 8

Kujdesi i duhur dhe profesionalizmi

Prokurori i kryen me kujdes dhe efikasitet detyrat e tij në kohë dhe pa vonesë. Funksionet e prokurorit ushtrohen me nivelin më të lartë të aftësive profesionale. Profesionalizmi dhe kujdesi i duhur janë parakushte për kryerjen e detyrave të prokurorit. Ushtrimi i funksioneve nga ana e prokurorit ka përparësi mbi të gjitha aktivitetet e tjera. Sipas këtij parimi, prokurori:

a) i trajton çështjet brenda një afati të arsyeshëm të përshtatshëm për çështjen në fjalë dhe në varësi të ngarkesës, pa cenuar cilësinë e vendimmarrjes, por në çdo rast jo përtej afateve ligjore. Për secilën procedurë, atje ku ligji nuk parashikon shprehimisht, ai kujdeset që të përcaktojë afate të arsyeshme për palët dhe për veten e tij;

b) i kushton kujdes çdo pretendimi të bërë për shkeljen e të drejtave të një subjekti të procedimit ose të një dëshmitari, duke përfshirë edhe pretendimet për keqtrajtim;

c) ia kushton veprimtarinë profesionale ushtrimit të funksionit;

ç) kujdeset që angazhimi i tij në veprimtari jashtë funksionit të mos cenojë kryerjen me cilësi të detyrave të tij si prokuror;

d) synon në mënyrë të vazhdueshme të arrijë nivele të larta të aftësive profesionale;

dh) ndërmer hapa të arsyeshëm për të ruajtur dhe për të rritur njohuritë, aftësitë dhe cilësitë personale, të nevojshme për kryerjen e detyrave të tij;

e) kujdeset për zhvillimin e aftësive të tjera, në përshtatje të risive teknologjike që lidhen me punën e tij;

f) bashkëpunon dhe ndërvepron me kolegët për shkëmbimin e përvojës dhe njohurive profesionale;

g) duhet të shfaqë përkushtim të posaçëm ndaj përgjegjësive të tij si drejtues apo zëvendësdrejtues i

zyrës së prokurorisë, krahas veprimtarisë së tij si prokuror. Prokurori me funksion drejtues duhet të tregojë shkallë të lartë përgjegjësie, aftësi organizative, drejtuese dhe komunikimi. Ai duhet të marrë masa për të garantuar aksesin e publikut në prokurori, në përputhje me ligjin dhe rregulloret e brendshme në fuqi, duke përfshirë edhe aksesin për personat me aftësi ndryshe;

h) gjatë ushtrimit të funksionit drejtues, në marrëdhënie me të tretët duhet të mbrojë imazhin e drejtësisë, të tregojë seriozitetin dhe dinjitetin që publiku pret nga sistemi i prokurorisë;

i) në marrëdhënie me institucionet dhe organizatat, prokurori bashkëpunon me profesionalizëm, duke respektuar kompetencat dhe pavarësinë e çdo institucioni, bazuar në parimet e bashkëpunimit, mosdiskriminimit, besimit reciprok, zbatimit të kërkesave ligjore dhe duke shmangur vonesat e panevojshme.

Neni 9

Respekti dhe aftësia për të dëgjuar

Prokurori duhet të tregojë respekt dhe vëmendje ndaj personave dhe dinjitetit të tyre. Ai duhet t'i kushtojë vëmendje prezantimit të fakteve dhe arsytimit ligjor të paraqitur nga palët dhe mbrojtësit e tyre ligjorë. Sipas këtij parimi prokurori:

a) sillet në një mënyrë dinjitoze, korrekte, të respektueshme dhe me mirëkuptim në marrëdhëniet e tij me subjektet procedurale, publikun dhe personelin administrativ;

b) dëgjon me vëmendje dhe merr parasysh në organizimin e punës së tij, kërkesat e të gjithë atyre që preken nga çështja që ai ndjek;

c) mban marrëdhënie korrekte me kolegët duke respektuar mendimin e tyre;

ç) respekton ushtrimin e detyrave dhe kompetencave prej personelit administrativ;

d) siguron që vlerat e respektit dhe të dëgjuarit të ndahen dhe respektohen nga të gjithë, gjatë kryerjes së detyrave të tij.

Neni 10

Trajtimi i barabartë

Trajtimi i barabartë i qytetarëve nga prokurori është thelbësor për performancën e duhur të



sistemit të prokurorisë. Sipas këtij parimi, prokurori:

a) përmbush funksionet e tij, duke shmangur çdo paragjykim dhe diskriminim ndaj subjekteve;

b) synon të shmangë situatat në të cilat individët mund të ndiejnë se po ndërmerret një qasje e njëanshme dhe i adreson këto situata në një mënyrë që të rritë besimin dhe respektin e publikut te prokuroria;

c) respekton individualitetin e gjithsecilit, duke garantuar trajtimin e barabartë si gjatë procesit, ashtu edhe në përfundim të çështjes;

ç) sillet në mënyrë të tillë që askujt të mos i krijohet përshtypja se është injoruar, përkrahur apo përbuzur;

d) duhet të përcjellë te prokurori i caktuar për marrëdhëniet me publikun dhe medien në mënyrë transparente dhe jodiskriminuese të gjitha informacionet që ky i fundit ndan me medien dhe publikun, për shkak të funksionit.

Neni 11

Transparenca

Publiku duhet të informohet mbi funksionimin e sistemit të prokurorisë. Sipas këtij parimi prokurori:

a) arsyeton aktet procedurale që ai harton në një gjuhë të qartë dhe të kuptueshme;

b) siguron transparencë në përputhje me legjislacionin në fuqi, në ruajtje të konfidencialitetit dhe respektimit të privatësisë ose rendit publik;

c) nuk abuzon me kërkesën për transparencë për ta shndërruar ushtrimin e funksionit në një shfaqje publike.

KREU III

AKTIVITETE JASHTË PROKURORISË

Neni 12

Aktivitetet tregtare

1. Pjesëmarrja e prokurorit në sipërmarrje tregtare duhet të jetë në përputhje me nenin 7, pika 4, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe legjislacionit në fuqi, duke u kujdesuar të shmangë konfliktin e interesit rast pas rasti.

Neni 13

Përfshirja në organizata komunitare

1. Prokurori duhet të tregojë kujdes që, përfshirja në organizata komunitare, nuk duhet të cenojë pavarësinë dhe të vendosë në rrezik statusin apo integritetin e funksionit. Këto aktivitete nuk duhet të jenë të ngarkuara ose që kërkojnë kohë të konsiderueshme sa të ndikojnë në performancën e detyrës dhe roli i prokurorit nuk duhet të përfshijë menaxhim aktiv të veprimtarisë së këtyre organizatave.

2. Prokurori përgjithësisht nuk duhet të përfshihet në mbledhje të fondeve. Duhet të tregohet kujdes për të konsideruar nëse apo deri në çfarë mase, emri apo funksioni i prokurorit do të lidhet me një kërkesë për mbledhje fondi, madje edhe për organizata bamirësie.

3. Konflikti i interesit që lidhet me përfshirjen në organizatat komunitare duhet të deklarohet sipas ligjit.

Neni 14

Referencat dhe rekomandimet

1. Prokurori mund të japë referenca të karakterit apo aftësisë profesionale për persona që ka bashkëpunuar dhe që njihen mirë prej tij.

2. Kjo detyrë duhet të kryhet vetëm në raste përjashtimore për një qëllim të caktuar.

3. Prokurori duhet të konsultohet me drejtuesin e zyrës së prokurorisë përpara se të vendosë të japë referencën apo rekomandimin.

Neni 15

Kartëvizitat

Prokurori duhet të jetë shumë i kujdesshëm kur përshkruan funksionin e tij në kartëvizita apo letra që mbajnë sipër logon e institucionit apo emrin e tij.

Neni 16

Dhuratat, mikpritja apo aktivitetet sociale

1. Prokurori duhet të jetë i kujdesshëm kur pranon ndonjë dhuratë apo mikpritje që mund t'i ofrohet, brenda kufirit ligjor.

2. Pranimi i ndonjë dhurate apo mikpritja në një vlerë modeste si shenjë vlerësimi mund të jetë e



pakundërshtueshme, në varësi me rrethanat. Për shembull, një prokuror që mban një fjalim ose merr pjesë në një aktivitet publik apo privat mund të pranojë një shenjë të vogël vlerësimi.

3. Prokurori mund të pranojë ftesa për drekë apo për darkë nga zyrtarë apo organizata profesionale në fushën e ligjit apo në fusha të tjera.

4. Prokurori duhet të tregojë kujdes kur ftohet të marrë pjesë në aktivitete që mund të përdoren si reklamë apo mbështetje, për shembull për zyra avokatie apo shoqata profesionistësh.

5. Prokurori duhet të kërkojë këshillën e drejtuesit të zyrës së prokurorisë, kur ka dyshime mbi pronësinë apo vlerën e dhuratës, përpara pranimit të saj.

6. Prokurori duhet të shmangë shoqërimin e drejtpërdrejtë me individë të të njëjtit profesion, që janë të përfshirë në çështje në proces apo në pritje për t'u përfaqësuar nga prokurori.

7. Prokurori ka detyrimin që të ruajë dinjitetin e detyrës dhe për të mos lejuar shoqërime që mund të ndikojnë negativisht në aftësinë e prokurorit për të kryer detyrën.

8. Prokurori duhet të ketë shumë kujdes për të shmangur situata të dyshimta njëanshmërie, në rast të lidhjeve të ngushta familjare apo sociale me një jurist, dëshmitar apo palë në një çështje, të cilat mund të përbëjnë shkaqe përjashtimi.

Neni 17

Përdorimi i pajisjeve

Prokurori nuk duhet të përdorë pajisje, përfshirë edhe pajisjet e teknologjisë së informacionit, të siguruar nga zyra e prokurorisë për përdorimin e tij personal. Udhëzime të detajuara mbi përdorimin e pajisjeve, duke përfshirë rëndësinë e moskompromentimit të sigurisë së tyre (në rastin e pajisjeve të IT-së) duhet të përcaktohen në rregulloret përkatëse.

Neni 18

Rrjetet sociale dhe forumet

1. Prokurori mund të përdorë rrjetet apo medien sociale.

2. Prokurori duhet të ndjekë udhëzimet që autoritetet përkatëse në juridiksionin e tij kanë lëshuar për sa i takon aspektit të sigurisë në këtë fushë.

3. Prokurori duhet të ndjekë rregullat e mëposhtme:

i. Prokurori duhet të sigurohet që informacioni mbi jetën personale të tij apo të saj dhe adresa e shtëpisë nuk është e vlefshme *online*;

ii. Prokurori duhet të jetë i kujdesshëm që të mos publikojë informacion personal më shumë se sa është i nevojshëm;

iii. Prokurori nuk duhet të postojë informacion që vë në rrezik sigurinë personale;

iv. Prokurori duhet të kontrollojë rregullimet e privatësisë dhe të kufizojë aksesin në profilin e tij nga publiku, për t'u siguruar që informacioni aksesohet nga një grup i kufizuar;

v. Prokurori duhet të kontrollojë termat dhe kushtet e ndonjë faqeje interneti, në të cilën hyn dhe të sigurohet që është i ndërgjegjshëm se kush posedon të dhënat e postuara në faqe dhe se çfarë mund të bëjnë me këto të dhëna poseduesit e faqes.

4. Prokurori mund të jetë aktiv në forume ose blogje të ndryshme.

5. Prokurori nuk duhet të japë opinion, duke bërë me dije që ai mban një funksion zyrtar, pasi mund të dëmtojë besimin e publikut për paanshmërinë apo sistemin e drejtësisë në përgjithësi. Kjo vlen edhe për pjesëmarrjen në forume ose blogje që pretendohet të jenë anonime.

KREU IV

ZBATIMI

Neni 19

Organet këshillimore dhe zbatuese

1. Çdo prokuror ka të drejtë të kërkojë nga Këshilltari për Etikën një opinion këshillimor për çështje të diskutueshme të etikës, lidhur me sjellje apo veprime të caktuara gjatë ushtrimit të funksionit apo jashtë tij, nëse ato konsiderohen ose jo në pajtim me standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes. Interpretimi i standardeve etike dhe rregullave të sjelljes nga Këshilltari për Etikën, lidhur me faktin, nëse rregulla përkatëse e lejon një sjellje të caktuar, mund të përdoret si mjet mbrojtjeje nga ana e prokurorit, në rast procedimi disiplinor, por ky interpretim nuk ka karakter detyrues për zgjidhjen e rasteve të tjera të ngjashme gjatë ushtrimit të kompetencave ligjore nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë.



2. Drejtuesi i zyrës së prokurorisë mbikëqyr respektimin e rregullave të sjelljes dhe etikën e prokurorit dhe raporton çdo problematikë në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, në kuadër të informacionit periodik që i kërkohet.

3. Shkelja e Standardeve të Etikës dhe Rregullave të Sjelljes së Prokurorit, kur nuk përbën shkak për përgjegjësi disiplinore, merret në konsideratë në kuadër të vlerësimit etik dhe profesional të prokurorit.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2022

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 160 lekë